



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Menaxhim Turizmi”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “LOGOS”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Klodiana Gorica
2. Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha

Schedione gowda Spang
Ermelinda Kordha

Janar/ 2023

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

Faqe 1

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Turizmi”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “LOGOS”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Menaxhim Turizmi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 1055 datë 29.07.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR Nr. 2380/3 Prot., datë 30.05.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UQSHA Nr. 17 datë 01.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 48, datë 05.07.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE/ 13 PAK
18	Numri i studentëve: (3 vitet e fundit)	10 studentë
19	Komente / të tjera:	-




TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Menaxhim Turizmi” është një program i ofruar nga Kolegji Universitar “Logos”, (KU Logos), si një institucion i arsimit të lartë me përvojë të gjatë në treg. Institucioni që po ofron këtë program studimi është i vendosur dhe pozicionuar qartë në tregun e arsimit të lartë në Shqipëri, si një institucion me mision për të ofruar cilësi dhe për të transmetuar vlera të mirëqenies sociale. Si rrjedhim edhe në ofrimin e programeve të studimit ai është i fokusuar dhe i përqendruar për të ofruar më tepër cilësi, sesa numra duke shfrytëzuar pikat e forta të eksperiencës në treg dhe duke eliminuar rreziqet e mundshme nga sipërmarrjet më të mëdha sesa kapacitetet në lidhje me degë të paeksploruara apo numra të papërbalueshëm nga strukturat e institucionit.

Edhe Departamenti i Menaxhimit si pjesë e fakultetit të ekonomisë, në ofrimin e programit të studimit në shqyrtim në këtë vlerësim të jashtëm, programi Bachelor në Menaxhim Turizmi, është një zbatues i mirë i strategjisë dhe politikave të institucionit, duke ofruar mundësi për studentët në një degë të përcaktuar prioritare sic është Turizmi. Kjo prirje është nuhatur që në fillimet e aktivitetit, pasi ky program studimi ka vite që ofrohet në treg, pikërisht për shkak të konsiderimit si një degë prioritare dhe me mundësi punësimi për të ardhmen për të rinjtë. Kjo e bën programin solid dhe me rekuizita për të patur sukses. Gjithashtu programi i studimit ka kaluar vlerësime të mëparshme dhe ka patur mundësinë për tu përmirësuar cilësisht, si nga pikëpamja formale ashtu edhe nga pikëpamja e brendshme dhe funksionale duke përmbushur kushtet për ofrimin e tij në një treg në zhvillim dhe ndryshim të vazhdueshëm, si ai i arsimit të lartë në Shqipëri.

Në këtë kontekst programi i studimit ka patur përmirësime dhe ofron mundësinë për të krijuar një numër profesionistësh të rëndësishëm në këtë sektor. Ai përfiton nga bashkëpunimet e ndryshme si me IAL të tjera, si me ish studentët Alumni ashtu edhe me botën e biznesit dhe akademinë. Angazhimi në program i pedagogëve me eksperiencë në sektorin e turizmit është një moment i rëndësishëm, por edhe përfshirja në program e stafit të brendshëm me specializime në fushën e turizmit duhet të ketë një vlerë shtesë për ecurinë e programit në një shkallë më të lartë. Në programin e studimit, studentët kanë mundësi të marrin njohuri dhe aftësi të mira në fushën e turizmit, por ka ende për të bërë për të krijuar një profil edhe më dinamik dhe të strukturuar duke u bazuar në proceset e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë dhe raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimet e dhëna nga akreditimi i fundit lidhen me disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë së institucionit në lidhje me këtë program studimi. Ato përfshijnë:

1. Rekrutimin e stafit efektiv për të mbuluar ngarkesën të paktën deri në masën 70%.
2. Garantimin e përputhshmërisë ndërmjet fushës së ekspertizës së stafit akademik të programit dhe lëndëve që ata mbulojnë në program.
3. Rishikimin e planit mësimor për të shtuar lëndë menaxheriale dhe integrimi i detyrave në vlerësimin përfundimtar.
4. Pasurimin e bibliotekës fizike dhe online për të gjitha lëndët dhe sidomos ato të karakterit turistik.
5. Digjitalizimin e të dhënave të stafit dhe përdorimin e një sistemi informacioni për studentët
6. Rritjen e promovimit të programit për të përmirësuar punësimin e të diplomuarve.


Duke u bazuar në të dhënat e ofruara nga institucioni dhe tabelat e ngarkesave të stafit mund të thuhet se është përmbushur rekomandimi i parë duke i përcaktuar stafit të brendshëm të institucionit ngarkesën në masën 70%. Ngarkesa për të gjitha lëndët e programit mbulohet edhe nga staf i brendshëm i fakultetit edhe nga stafi i departamentit, i cili është rritur edhe në gradat shkencore, gjatë kësaj periudhe. Kjo siguron edhe përmbushjen e pikës së dytë, pra garantimin e përputhshmërisë ndërmjet fushës së ekspertizës së stafit me lëndët që ata mbulojnë. Kjo duket edhe nga CV-të e stafit dhe kualifikimet përkatëse.

Sa i përket pikës së tretë për tu përmbushur, plani mësimor aktual përmban një seri lëndësh që ndikojnë në formimin e plotë menaxherial të studentëve, jo vetëm duke përmbushur rekomandimet, por duke krijuar një bazë të mirë për programin. *Gjithsesi përmirësimet të mëtejshme të vogla duhet të bëhen për tu qëndruar dinamikave të kohës, kryesisht drejt lëndëve të menaxhimit të turizmit.*

Biblioteka fizike dhe ajo online përmbajnë tituj të rëndësishëm dhe të kohëve të fundit për lëndët e programit të studimit. Gjithashtu të gjitha lëndët e turizmit kanë literaturën e përshtatshme në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e huaj.

Institucioni gjithashtu ka bërë shumë hapa përpara drejt digjitalizimit të të dhënave, duke përdorur dy platforma online, Edupage dhe TEAMS, përveç web-site dhe mediave sociale, si për informimin e studentëve dhe shpërndarjen e materialeve, ashtu edhe për qëllime të përpunimeve të të dhënave në dobi të institucionit.

Në gjykimin e GVJ Institucioni ka përmbushur edhe pjesën e promovimit të programit duke u munduar të krijojë marrëdhënie me aktorë të tregut të punës. Këto përpjekje duket se do të thellohen edhe në të ardhmen, me synim për të rritur numrin e studentëve në këtë program studimi.




Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Procesi i vlerësimit të jashtëm paraqitet si një proces që ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë dhe gjithë bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procedura përfshiu fillimisht ngritjen e GVJ, kontaktimin e ekspertëve pjesë e GVJ si edhe përdorimin e sistemit elektronik në pjesën e panelit të ekspertit, për aksesimin e dokumentacionit përkatës. Instalimi i komunikimit të mirë në grupin e punës midis ekspertëve dhe menaxherit teknik nga ASCAL ishte një hallkë e rëndësishme për ecurinë e procesit. Pas njohjes dhe shfrytëzimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni për diplomën përkatëse, u ndërtua një axhendë për vizitën në institucion dhe hapi i radhës natyrshëm ishte realizimi i saj. Axhenda u zbatua me rigorozitet, duke ndikuar pozitivisht në mbledhjen dhe grumbullimin e informacioneve të mëtejshme të cilat do të ndikonin në një vlerësim bazuar mbi informacion sa më të detajuar. Pas vizitës në terren u realizua raporti përfundimtar nga ekspertët e jashtëm dhe ky u dorëzua për rishikim nga ASCAL dhe për njohjen me të të GVB. Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi është Specialistja e ASCAL, Znj Aviola Bardhi.

Më datë 11/01/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 16 Prot., datë 11/01/2023, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

KU "LOGOS" kthehu përgjigje, përmes AMS, më datë 24/01/2023 dhe me shkresë zyrtare Nr. 22 Prot., datë 19/01/2023.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.



Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Turizmi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programet e studimit të ofruara nga KU Logos përputhen me prioritetet kombëtare dhe nevojat lokale. Kështu përmes ofrimit të programit të studimit përmbushen nevojat që ka tregu shqiptar për specialist dhe ekspertë të fushës së turizmit. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është hartuar bazuar në strategjinë e Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe synon përmbushjen e misionit dhe qëllimit të institucionit në shpërndarjen e dijes. Në misionin e tij, Kolegji Universitar “LOGOS” ka në fokus zhvillimin e dijeve, përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, të ofrojë mundësi më të mira për mësimin e vazhduar gjatë gjithë jetës bazuar në prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit. Kolegji Universitar “Logos” bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Kolegjit Universitar “LOGOS”, njësitë bazë janë fuqizuar të përshtasin veten e tyre dhe ofertën e tyre akademike, ekzistuese apo të projektuar, sipas objektivave institucionale, kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Shtojca nr.14: Planet mësimore 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022;</i> <i>Shtojca nr. 19: Syllabuset sipas viteve akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022</i> <i>Shtojca nr.2: Statuti i KU “LOGOS”, Neni 3</i> <i>Shtojca nr.3: Plani Strategjik i KU “LOGOS”, 2018-2024</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Qëllimi i programit është të formojë specialistë të aftë në fushën e Turizmit, të cilët mund të ofrojnë shërbimet e tyre si në sektorin publik dhe atë privat, me njohuri të mjaftueshme për të punuar apo drejtuar në njësi ekonomike turistike, të kontribuojë për përcaktimin e modelit më të përshtatshëm të zhvillimit të turizmit në vendin tonë duke shfrytëzuar përvojat ekzistuese pozitive në vend dhe jashtë tij, të jetë koherent me ndryshimet e tregjeve të sotme turistike në zbatim të strategjisë dhe politikave të hartuara në fushën e zhvillimit të Turizmit. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, ofruar nga Kolegji Universitar “LOGOS”, jo vetëm që ndihmon në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare, por synon edhe në promovimin e kulturës dhe traditës shqiptare. Duke u bazuar tek ecuria e studentëve dhe strategjia e Kolegjit Universitar “LOGOS” dëshmohet se ky program është në vazhdim të ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e kulturore kombëtare e shkencore. Gjithashtu, në Rregulloren e Programit të Studimit Bsc në Menaxhim Turizmi, Neni 3, shpreh qartë misionin e programit të studimit që është “të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë njohuritë bazë përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, me synimin të formojë specialistë të lartë në sektorin e Turizmit në përputhje me prioritetet e

	<p>zhvillimit të vendit, për të kontribuar në të ardhmen dhe në mbështetje të politikave të përfshirjes në zhvillimet rajonale dhe europiane turistike”</p> <p><i>Shtojca nr.7: Rregullore e programit të studimit Bsc. Menaxhim Turizmi, Neni 3</i></p> <p><i>Shtojca nr.3: Plani Strategjik i KU “LOGOS”, 2018-2024</i></p> <p><i>Shtojcat nr.59.1, 59.2, 59.3, 59.4, 59.5, 59.6: webinar, workshop, tryeza të rrumbullakëta, leksione të hapura, konferenca studentore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të parë “Menaxhim Turizmi” në përgjithësi synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Pajisja e studentëve me njohuritë bashkëkohore profesionale dhe shkencore në fushën e turizmit dhe formimin e shprehive praktike në këtë sektor. ● Të përgatisë specialistë të lartë në zbatimin e politikave dhe strategjive turistike në administratën publike në nivel qendror dhe vendor të institucioneve që kanë objekt veprimtarie në sektorin e turizmit edhe në atë privat; ● Të përgatisë specialistë në menaxhimin e burimeve njerëzore, komunikimit dhe marketingut në sektorin e turizmit; ● Të përgatisë konsulentë të sipërmarrjeve në sektorin e turizmit dhe menaxherë të projekteve turistike me financim vendas dhe të huaj; ● Të përgatisë specialistë për orientimin e investimeve turistike në përputhje me zbatimin e normave ndërkombëtare turistike për realizimin e një turizmi të qëndrueshëm. ● Të përgatisë specialistë për të hartuar dhe menaxhuar produkte cilësorë turistike. <p>Këto objektiva ky program i mbështet totalisht në strategjinë e institucionit dhe duke kaluar më tej në dokumentat strategjike të departamentit në përgjithësi dhe për këtë program studimi në vecanti. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është hartuar bazuar në strategjinë e Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe synon përmbushjen e misionit dhe qëllimit të institucionit në shpërndarjen e dijes. Në misionin e tij, Kolegji Universitar “LOGOS” ka në fokus zhvillimin e dijeve, përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, të ofrojë mundësi më të mira për mësimin e vazhduar gjatë gjithë jetës bazuar në prioritet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit Ky mision dhe qëllim është shprehur dhe në Rregulloren e programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi.</p> <p><i>Shtojca nr.3: Plani Strategjik i KU “LOGOS”, 2018-2024</i></p> <p><i>Shtojca nr.2: Statuti i KU “LOGOS”, Neni 3</i></p> <p><i>Shtojca nr.7: Rregullore e programit të studimit Bsc në Menaxhim Turizmi, neni 2,3</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Politikat zhvillimore të programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi hartohen në përputhje me zhvillimin arsimor, social, ekonomik të shoqërisë, si nevojë e tregut të punës. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, vjen si një kërkesë e tregut dhe prioriteve kombëtare si Turizmi dhe Kultura. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, jep një</p>

	<p>kontribut në edukimin dhe formimin e specialistëve të menaxhimit të burimeve njerëzore, komunikimit dhe marketingut.</p> <p>Shtojca nr.54: Prioritetet Kombëtare; Shtojca nr.54.1 Programi i qeverisë 2017-2021, https://kryeministria.al/epcontent/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf);</p> <p>Shtojca nr.54.2: Vendim Nr.386, Datë 01.06.2022. (Vendimi nr.386, datë 1.06.2022 “ PËR MIRATIMIN E FUSHAVE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR DHE MBËSHTETJEN FINANCIARE TË STUDENTEVE TË SHKËLQYER E STUDENTËVE QË NDJEKIN KËTO PROGRAME NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”, https://www.facebook.com/kulogos.edu.al/photos/a.1081565455255832/2298687253543640/).</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Misioni dhe objektivat e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është në përputhje edhe me priroritët e planit strategjik Institucional si “Përmbushja e Standardeve Akademike; Kërkimit; Parteneritetit”, me qëllim përsosmërinë dhe përditësimi e kurrikulës, programeve mësimore, kërkimi shkencor, krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të partneritetit me punëdhësit sipas nevojave të tregut. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është hartuar bazuar në Statutin, Rregulloren, Strategjinë e KU “LOGOS” dhe synon përmbushjen e misionit dhe qëllimeve të institucionit në shpërndarjen e dijes, standartet ndërkombëtare, si dhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë ky institucion i arsimit të lartë në vendin tonë dhe më gjërë.</p> <p>Shtojca nr.2: Statuti i KU “LOGOS”, neni 3; Shtojca nr. 5: Rregullore e Përgjithshme e KU “LOGOS”, neni 64, 65; Shtojca nr.3: Plani Strategjik i KU “LOGOS” 2018-2024, prioriteti strategjik nr 2; Shtojca nr.7: Rregullore e Programit të studimit Bsc në “Menaxhim Turizmi” neni 3, 4). Shtojca nr. 60: Organigrama e KU “LOGOS”, Shtojca nr.2: Statuti i KU “LOGOS”; Shtojca nr.5: Rregullore e Përgjithshme e “KU LOGOS”; Shtojca nr.6: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit; Shtojca nr.7: Rregullore e Programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi;</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. Të gjitha dokumentat</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web-site: www.ascal.al

Faqe 8



<p>drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>strategjike janë në përputhje dhe mbështetje të njëra tjetrës, duke reflektuar në këtë mënyrë se statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> <p><i>Shtojca nr. 60: Organigrama e KU "LOGOS", Shtojca nr.2: Statuti i KU "LOGOS";</i> <i>Shtojca nr.5: Rregullore e Përgjithshme e "KU LOGOS";</i> <i>Shtojca nr.6: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit;</i> <i>Shtojca nr.7: Rregullore e Programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi;</i></p>		
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi është gjithëpërfshirës dhe përkon specifikiisht me nevojat e mëdha që ka tregu shqiptar për ekspertë dhe manaxherë të turizmit. I pasuar dhe me një master të profilizuar përbën në këtë mënyrë një formulë ideale jo vetëm për studentët që mbarojnë nivelin e 1 të studimeve të vijojë profilizimin e tij, por edhe për të profilizuar nivelet e dyta sipas nevojave të vendit. Fakti që ofrohen të dy programet në të njëjtën kohë nga KU Logos forcon edhe më shumë jo vetëm imazhin dhe rrit vëmëndjen nga tregjet e synuara, por garanton cilësinë dhe qëndrueshmërinë afatgjatë. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit, si njësi bazë e Fakultetit Ekonomik. Ky program është hartuar bazuar në Rregulloren e Përgjithshme të Kolegjit Universitar "LOGOS", Statutin e Institucionit, dhe Rregulloren e Fakultetit Ekonomik.</p> <p><i>Shtojca nr. 60: Organigrama e KU "LOGOS", Shtojca nr.2: Statuti i KU "LOGOS";</i> <i>Shtojca nr.5: Rregullore e Përgjithshme e "KU LOGOS";</i> <i>Shtojca nr.6: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit;</i> <i>Shtojca nr.7: Rregullore e Programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi;</i> <i>Tabela nr.12. Plani mësimor i lidhur me personelin akademik</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Ky program i studimit Manaxhim në Turizëm ka një koherencë të gjatë në treg, dhe madje përbën një ndër programet e para të turizmit në tregun vendas. Kjo do të thotë se suporti dhe bindja e institucionit është e fortë dhe në krah të plotë të mbështetjes së këtij institucioni. Kjo gjë u identifikua dhe rezultoi mjaft e qartë edhe përgjatë vizitës në institucion si me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë po ashtu edhe nga stafi i brëndshëm me grada dhe kualifikuar, të cilët reflektuan një mbështetje të plotë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 9

	<p>ndaj këtij programi studimi. Pra të gjitha dokumentat, raportet e shkruara dhe të paraqitura, por edhe të gjitha takimet e realizuara dhe veçanërisht me stafin, grupin e RVB dhe drejtuesit e departamentit dhe fakultetit konfirmuan mbështetjen për formimin e studentëve, për aftësimin dhe kompetencat e tyre në përfundim të programit, duke qënë shumë të hapur ndaj cdo sugjerimi nga grupi i vlerësimit të jashtëm.</p> <p><i>Shtojca nr.7: Rregullore e Programit të studimit Bsc. "Menaxhim Turizmi", neni 4 dhe 10</i></p> <p><i>shtojca 14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. Menaxhim Turizmi;</i></p> <p><i>Shtojca nr. 20: Cv e stafit akademik të programit të studimit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Me anë të Vendimit të Këshillit të Akreditimit Nr. 338, datë 8.6.2012, të shpallur me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 282, datë 04.07.2012, u akreditua programi i studimit, i ciklit të parë të ofruara nga SHPL "LOGOS".</p> <p>Akreditimi i fundit i programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi" me vendim të Bordit të Akreditimit Nr.48, datë 05.07.2019, "Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Menaxhim Turizmi", të Kolegjit Universitar "LOGOS.</p> <p>Institucioni studion dhe analizon në mënyrë periodike tendencat e zhvillimit të tregut të punës në planin kombëtar dhe ndërkombëtar bazuar në studimet e bëra nga INSTAT, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, UNËTO, Ministria e Ekonomisë, FMN, BB, BERZH, publikime të Bankës së Shqipërisë, zyra e medias etj, lidhur me zhvillimet ekonomike ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale dhe bën sugjerimet dhe përshtatjet e nevojshme në Plani strategjik të KU LOGOS, 2018-2024</p> <p>Ky informacion mbështet faktin se Kolegji Universitar Logos ka një koherencë të gjatë dhe relativisht të qëndrueshme në ofrimin e këtij programi studimi, pra ka patur të gjithë kohën e mjaftueshme për të synuar përmirësime në formë dhe përmbajtje. Por këtë gjë ka patur mundësi ta bëjë edhe përmes dy burimeve të tjera:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. përmes reflektimeve të specialistëve të tregut që ndërkohë janë edhe mësimdhënës të jashtëm pranë këtij programi si dhe, 2. përmes marëveshjeve të bashkëpunimit që janë vecanërisht eficiente. <p>Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës mbështet në realizimin e këtij objekti përmes funksionalitetit të vet dhe detyrave që realizon, pjesë e funksionit të së cilës është informimi dhe këshillimi i studentit që në momentin e parë të regjistrimit dhe mbajtjen e marrëdhënieve të vazhdueshme gjatë studimeve dhe pas përfundimit të tyre, nëpërmjet Rrjetit ALUMNI. Plani mësimor është një instrument për realizimin</p>

	<p>dhe permbushjen e këtyre objektivave. Kështu, programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, ofron gjithashtu, lëndë të formimit të përgjithshëm, përvec atyre të karakterit profesional, duke i pajisur studentët me aftësi gjithëpërfshirëse, me qëllim përshtatjen e studentit me tregun e punës si Parimet Bazë të Menaxhimit, Menaxhim Burimesh Njerëzore, Menaxhim Projektsh etj. E ofruar dhe në formë bashkëbisedimi dhe e dakortësuar edhe me stafin, janë ofruar disa sugjerime që synojnë përmirësime strukturore dhe të përmbajtjes së këtij programi studimi.</p> <p><i>14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2021-2022).</i></p> <p><i>17.3. Të dhëna për punësimin e studentëve; Shtojca nr.57 Vlerësim punëdhënësi për ALUMNI, Shtojca 55. Turizmi në Shifra).</i></p> <p><i>Shtojca nr.3: Plani Strategjik i KU "LOGOS" 2018-2024, prioritet I, II (objektivi 1 dhe 2) prioriteti IV (objektivi 1,2,3), prioriteti VI; Shtojca nr.56: Vendime Senati Akademik për riorganizimin e njësive bazë;</i></p> <p><i>Shtojca nr.56.1: Vendimi i Senatit Akademik dhe njoftimi në MASR e riorganizimit të njësive bazë;</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Dijet dhe aftësitë e studentëve, shkathtësitë dhe kompetencat janë në qëndër të këtij program studimi. Kjo është e përcjelle jo vetëm nga takimet e realizuara në institucion, por edhe vecanërisht nga dokumentat shoqëruese dhe justifikuese, që nga studimet e tregut, marrëveshjet e bashkëpunimit, të cilat e bëjnë një program me fokus studentin, rrjedhimisht dhe dijen dhe aftësitë e tyre.</p> <p>Me qëllim që ky program të përmirësojë cilësinë dhe të shndërrohet në një program konkurrues ndaj programeve të IAL-ve të tjera në tregun vendas, është e nevojshme reflektimi i sugjerimeve të dhëna edhe në fund të këtij raporti (në formën e rekomandimeve). Këto sugjerime mund të reflektohen gradualisht, qoftë në masën 20% për çdo vit akademik, por gjithsesi konsiderohen të rëndësishme për më tej. Kështu, psh një ndër sugjerimet lidhet me planin mësimor. <i>Konsiderohet e nevojshme të përfshihet 1 lëndë turizmi që në vitin e parë të studimeve dhe viti i tretë të vijojë totalisht me lëndë të turizmit sikurse është aktualisht, por të shikohet mundësia të shtohen grupi i lëndëve me zgjedhje në semestrin e dytë të vitit të tretë me një shportë të lëndëve të turizmit. Ndërkohë që, sugjerohet që roli i stafit të jashtëm të jetë më aktiv jo vetëm në përmirësim të kurrikulave por vecanërisht në rritje të numrit të studentëve për këtë program studimi.</i> Psh, sugjerimet që prodhon ky raport i jashtëm i vlerësimit duhej në fakt të kishin ardhur kahershëm edhe nga stafi i jashtëm, duke qënë se është rrjedhimisht më shumë i lidhur me tregun, dhe më i ndikuar ndaj ndryshimeve që duhet të pësojnë kurrikulat nga dhe për shkak të evoluimit të</p>

	tregut. <i>Shtojca nr.3: Plani Strategjik i KU "LOGOS", 2018-2024, prioritet 2,3,4</i> <i>Shtojca nr.14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2021-2022</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Nga akreditimi i mëparshëm, KU Logos i janë lënë mjaft detyra të lidhura me shumë elemente. Vihet re edhe nga analizat e dokumentave por edhe raportet përkatëse se ato janë përmbushur cilësisht dhe se KU Logos ende vijon të synojë rritjen e cilësisë dhe mbarëvajtjen mësimore. Teksa ka bërë përpjekjet për të mirëplotësuar detyrat e lëna nga akreditimi, KU Logos ka rezultuar me një përmirësim më cilësor, me një përputhshmëri të fushës së ekspertizës të stafit të angazhuar në këtë program (<i>megjithëse ende vihen re në lëndë të vecanta se staf me profil jo të turizmit është i përfshirë në mësimdhënie të lëndëve që lidhen me turizmin</i>), ka pasuruar bibliotekën fizike dhe atë online, etj, pra në këtë mënyrë ka rritur kapacitetet dhe burimet në fushën përkatëse akademike.</p> <p><i>Shtojca nr. 91.2 VKM nr. 1055 dt. 29.07.2009 mbi licensimin e shlp logos;</i> <i>shtojca nr. 91.3 Urdher 396 per lejimin e ushtrimit te vepramtarise se shlp logos</i> <i>shtojca nr. 61.1 Vendimet e Bordit të Akreditimit nr. 48;</i> <i>shtojca nr. 61.2 VKA nr.388, dt.08.06.2012</i> <i>Urdher MASH nr. 282 dt. 04.07.12)</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Misioni dhe objektivat e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është në përputhje edhe me prioritetet e planit strategjik Institucional si "Përmbushja e Standardeve Akademike; Kërkimit; Parteneritetit", me qëllim përsosmërinë dhe përditësimin e kurrikulës, programeve mësimore, kërkimi shkencor, krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të partneritetit me punëdhësit sipas nevojave të tregut. Programi i studimit Bachelor në "Menaxhim Turizmi" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Menaxhimit. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, ofron gjithashtu, lëndë të formimit të përgjithshëm, përveç atyre të karakterit profesional, duke i pajisur studentët me aftësi gjithëpërfshirëse, me qëllim përshtatjen e studentit me tregun e punës si Parimet Bazë të Menaxhimit, Menaxhim Burimesh Njerëzore, Menaxhim Projektesh etj.</p>


	<p>Departamenti i Menaxhimit ofron edhe programin Bachelor në Menaxhim Biznesi, fusha akademike dhe kërkimore e të cilit plotëson programin e Menaxhim Turizmit në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e biznesit turistik</p> <p><i>Shtojca nr.14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2021-2022</i></p> <p><i>Shtojca nr.3: Plani Strategjik i KU "LOGOS", 2018-2024, prioritet 2,3,4</i></p> <p><i>Shtojca nr.14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2021-2022;</i></p> <p><i>Shtojca Tabela nr.4. Gjithashtu, veprimtaria kërkimore e personelit akademik është në përputhje me kurrikulën e programit të studimit</i></p> <p><i>Shtojca nr.43: Të dhënat për kualifikime kërkim shkencor për 5 vitet e fundit</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në Menaxhim Turizmi ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë njohuritë bazë përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, aftësi dhe kompetenca praktike me synimin të përgatisin profesionistë në fushën e Menaxhimit të profilizuar për biznes dhe turizëm.</p> <p>Qëllimi i programit është të formojë specialistë të aftë në fushën e Turizmit, të cilët mund të ofrojnë shërbimet e tyre si në sektorin publik dhe atë privat, me njohuri të mjaftueshme për të punuar apo drejtuar në njësi ekonomike turistike, të kontribuojë për përcaktimin e modelit me të përshtatshëm të zhvillimit të turizmit në vendin tonë duke shfrytëzuar përvojat ekzistuese pozitive në vend dhe jashtë tij, të jetë koherent me ndryshimet e tregjeve të sotme turistike në zbatim të strategjisë dhe politikave të hartuara në fushën e zhvillimit të Turizmit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është totalisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në vitin 2018 në strukturën organizative të Kolegji Universitar "LOGOS" u shtua njësi kryesore Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, i cili ka në përbërje të tij tre Departamente. Fakulteti Ekonomik në vitin 2019 bëri një riorganizmi të strukturës së tij duke u riorganizuar në tri departamente (Shtojca 91.8):</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Departamenti i Financë-Kontabilitet, ● Departamenti i Menaxhimit, ● Departamenti i Agrobiznesit <p>Në Departamentin e Menaxhimit u përfshi programi i studimit Bachelor "Menaxhim Turizmi", i cili u ri-akreditua me Vendim të Bordit Akreditimit Nr. 48, datë 05.07.2019, për një periudhë tre vjeçare. Pra kjo njësi është krijuar dhe zhvilluar gradualisht në mënyrë institucionale duke konsideruar rritjen si një proces hap pas hapi. Në përfundim të këtij programi studimi, studentët kanë fituar njohuri të specializuara bashkëkohore në fushën e Menaxhimit të Turizmit, aftësi praktike për zgjidhjen e problemeve të menaxhimit</p>

	dhe kompetenca për zbatimin e strategjive të sukseshme në zhvillimin e qëndrueshëm të një biznesi në sektorin e turizmit. <i>Shtojca nr.7: Rregullore e Programit të studimit Bsc. "Menaxhim Turizmi", neni 4 dhe 10</i> <i>Shtojca 14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. Menaxhim Turizmi</i> <i>Shtojca nr. 20: Cv e stafit akademik të programit të studimit).</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.5


Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Programi i studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në Menaxhim Turizmi ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbeshtese ofrimin e njohurive bazë përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, aftësive dhe kompetenca praktike me synimin e përgatitjes së profesionistë në fushën e Menaxhimit të profilizuar për biznes dhe turizëm. Për të munduruar realizueshmërinë cilësore të këtij programi të reflektuar edhe në përcaktimin e misionit, KU Logos, dhe vecanërisht Departamenti përkatës që e ofron këtë, ka përgatitur të gjithë dokumentacionin shoqërues, shpjegues dhe argumentues. Kështu, ka një ndarje të mirë të detyrave dhe njësive përkatëse brenda institucionit të cilat merren me të gjitha hallkat që nga promovim i programit, regjistrimi i studentëve, ndjekja e tyre përgjatë gjithë procesit, tërheqja e opinionit të tyre, vlerësimi dhe reflektimi i feedback përkatës. Kjo gjë identifikohet jo vetëm nga dokumentat përkatës të institucionit KU Logos të vëna në dispozicion, por edhe përgjatë vizitave në terren me të gjitha njësitë përkatëse. Kjo mund të konsiderohet një pikë e fortë jo vetëm për këtë program studimi sepse e mbështet cilësisht programin, por për të gjithë KU Logos. Infrastruktura e organizuar mjaft mirë përbën një argument të fortë mbështetës jo vetëm për mbarëvajtjen cilësore të programit dhe të ardhmen e tij, por edhe për qëndrueshmërinë e të gjithë institucionit. Kështu, KU Logos për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit ka strukturuar organigramën e brendshme dhe siguruar marrëdhënie bashkëpunimi brenda tij nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive te personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> <p>Kolegji Universitar "LOGOS" ka krijuar struktura si Komisioni i Përhershëm i Garantimit dhe Sigurimit të Cilësisë së Institucionit dhe Programeve të Studimit' dhe Njësinë e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë si dhe një sërë dokumenta mbështetëse, të cilat mbështetën tek Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Manualin e ASCAL për</p>




	<p>vlerësimin institucional dhe të programeve të studimit (Shtojca nr.13: Politika për sigurimin e Cilësisë; Shtojca nr.8: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë). Departamenti i Menaxhimit ushtron lirinë e tij akademike për përmirësimin e programit të studimit bazuar konform legjislacionit, Statutit, Rregullores së Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe Rregullores së Programit të studimit Bsc në Menaxhim Turizmi. <i>Shtojca nr.8: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë; Shtojca nr.6: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit, neni 38</i> <i>Shtojca nr.13: Politika për sigurimin e Cilësisë; Shtojca nr.8: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë</i> <i>Shtojca nr.17: Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve; 17.3 Të dhëna për punësimin e studentëve;</i> <i>Shtojca nr.7: Rregullore e programit të studimit Bsc në Menaxhim Turizmi, neni 39, 40, 41;</i> <i>Shtojca nr.52: Shkresa dërguar MASR për ndryshimet 20 % 08.04.2019</i> <i>Shtojca nr.60: Organigrama e KU “LOGOS”</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Një ndër pikat e forta është pikërisht marrëdhëniet me institucione jashtë KU Logos në funksion të mbarëvajtjes së këtij programi studimi. Këto marrëdhënie përveç se të identifikuar dhe certifikuar si marrëveshje bashkëpunimi, janë të realizuara të gjitha duke siguruar një ndikim cilësor në kryerje të praktikave mësimore, në procese mesimdhënëse, etj. <i>Edhe njëhere sugjerohet që marrëdhëniet që mbartin dhe sjellin brenda programit stafi i jashtëm mesimdhënës duhet të synojnë më fort rritjen e studentëve të regjistruar vitin e parë, pra marrëdhëniet e bashkëpunimit nga stafi i jashtëm duhet të prodhojnë edhe sasi, pra rritje të nr të studentëve për këtë program studimi.</i> Në funksion të plotësimit të rekomandimeve të vëna nga akreditimi i mëparshëm, citohet se në lidhje me rekomandimin 6: <i>Institucioni të rrisë promovimin e programit të studimit për të përmirësuar punësimin e të diplomuarve,</i> nga ana e KU Logos është dhënë shpjegimi: Institucioni, KU Logos ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të mesëm, për zhvillim aktivitetesh të përbashkëta. Aktivitetet përfshijnë organizimin në KU “LOGOS” të orëve të këshillimit të karierrës për maturantët dhe nxënësit e vitit të dytë të Gjinnazit “Protagonistët” në Tiranë dhe të Shkollës së mesme “Ekonomike” Tiranë, veprimtari me tema të përcaktuara me lektorë pedagogët e KU “LOGOS”. <i>Shtojca nr.63: Zyra Erasmus +</i> <i>Shtojca nr.63.1: Student mobility</i> <i>Shtojca nr.63.2: Raport mbi Erasmus +</i> <i>Shtojca nr.63.3: Staff mobility, Lëvizja e stafit dhe studenteve në kuadër të programit Erasmus +</i> <i>Shtojca nr.63.4: Informimi i studentëve për Erasmus;</i> <i>Shtojca nr.34.3: Marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset</i> <i>Shtojca nr.34.4: Marrëveshje bashkëpunimi KU Logos me institucione joarsimore</i></p>

	<p><i>Shtojca nr.34.5: Marrëveshje bashkëpunimi KU Logos me KOASH, Shtojca nr.34.6: Marrëveshje bashkëpunimi KU Logos me Frymë Dashurie).</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Kolegji Universitar “LOGOS” me qëllim përmbushjen e vizionit të programit bashkëpunimi i Institucionit me korporatat dhe shkëmbimi i praktikës midis stafit që është përgjegjës për shërbime të tilla si: këshillimi, metoda dhe mjetet e trajnimit, shërbimeve mbështetëse studentore, rrisin cilësinë në kuadër të realizimit të objektivave të programit të misionit, në fokus të strategjisë të tij, ka edhe bashkëpunimin (partneritetin) mes Institucioneve Arsimore brenda dhe jashtë vendit, partnerëve të bizneseve me qëllim përmbushjen e objektivave të studimit. Si rezultat i këtyre marrëveshjeve janë ndërtuar analiza në departamente dhe rrjedhimisht raporte vjetore, institucionale dhe mbi Erasmus+.</p> <p><i>Shtojca nr.65: Raporte Vjetore Institucionale</i> <i>Shtojca nr.65.1: Raporti vjetor 2019-2020_Kolegji Universitar LOGOS, Shtojca nr. 65.2: Raporti vjetor Insititucional 2020-2021</i> <i>Shtojca nr.63.2: Raport mbi Erasmus +</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, e cila bashkëpunon me Departamentin e Menaxhimit për krijimin e bazës së të dhënave me sugjerimet përkatëse nga rrjeti Alumni dhe punëdhënësit e studentëve. Mbi këtë bazë të dhënash Departamenti rishikon, dhe përmirëson kurrikulën e programit të studimit dhe i ofron tregut të punës një program studimi më konkurrues. Por mbi bazën edhe të kësaj siguron edhe një mirëshpërndarje të studentëve për të kryer praktikat mësimore. Kolegji Universitar “LOGOS” ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe private në vend për kryerjen e praktikave profesionale, të cilat në shumicën e rasteve kanë ofruar edhe punësim të mëtejshëm për studentët tanë përtej zhvillimit të praktikës. Sikurse është përmendur edhe më lart mënyra e realizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe kthimi i tyre në marrëveshje eficiente është identifikuar së pari përmes realizimit efektiv të praktikave mësimore si pjesë e detyrimit dhe përmbylljes së këtij programi studimi. E konsultuar edhe përgjatë vizitës në institucion e vu re se Departamenti i Menaxhimit bazuar në rregulloren e Departamentit, neni 51 “Zhvillimi i praktikave profesionale” vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale.</p> <p><i>Shtojca nr.57.2: Formular i Vlerësimit nga kompania për ish-studentin ALUMNI</i> <i>Shtojca nr.34: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe ose të huaj dhe për praktikën profesionale</i> <i>Shtojca nr.6: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit, Neni 51</i> <i>Shtojca nr.7: Rregullore e programit të studimit neni 31</i></p>



	<p><i>Shtojca nr.17: Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve;</i> <i>17.3 Të dhëna për punësimin e studentëve;</i> <i>Shtojca nr.7: Rregullore e programit të studimit Bsc në Menaxhim Turizmi, neni 39, 40, 41;</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës pranë Kolegjit Universitar “LOGOS” disponon të dhëna statistikore mbi punësimin e të diplomuarve. Keto te dhëna te kordinuara me analizat e raporteve qe dalin nga studentet prodhojne outpute te rendesishme per te siguruar nje vazhdimesi cilesore te programit, por vecanerisht per te prodhuar nje alumni eficient.</p> <p>Kolegji Universitar “LOGOS” ndjek politika të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve. Aktualisht, pjesë e stafit të Kolegjit Universitar “LOGOS” janë 5 ish-studentë, të cilët kanë përfunduar studimet pranë institucionit.</p> <p><i>Shtojca nr.17.3 Të dhëna për punësimin e studentëve;</i> <i>Shtojca nr.65.2: Raporti vjetor Insititucional 2020-2021;</i> <i>Tabela nr.12</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR


Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Bsc Menaxhim Turizmi është një ndër programet e para të studimit që ka hapur Kolegji Universitar “LOGOS”. Akreditimet e marra dëshmojnë se Kolegji Universitar “LOGOS” ka përvenc përvojës specifike për ofrimin e programi studimi Bsc Menaxhim Turizmi, por vecanërisht përpjekjen dhe mbështetjen e vazhduar për të vijuar investimin në zhvillimin e këtij program studimi. E cilësuar edhe në dokumentat strategjike, planet dhe objektivat e mirëkordinuara dhe cituara në dokumentat përkatës, ekziston një mirëkordinim dhe përcaktim i moduleve, krediteve, orëve brenda syllabuseve, duke përmbledhur brenda një kornize të rregullt të gjithë informacionin. Misioni dhe objektivat e këtij program studimi janë në vijë të njëra tjetrës, objektivat zëbrahen dhe mbështesin misionin, si dhe në koherencë të të gjitha dokumentave strategjikë të insitucioni KU Logos.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Mënaxhim Turizmi organizohet në përputhje me nenin 73 të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dt.22/07/2015. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, ofrohet me jo më pak se 180 kredite (ECTS), me një kohëzgjatje normale prej tre vitesh akademike. Në përfundim të këtij cikli, studentët pajisen me diplomë Bachelor në Menaxhim Turizmi. Program i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh përmes moduleve dhe syllabuseve përkatëse të cilat janë të mirëstrukturuar dhe me përmbajtje të plotë të të gjithë elementëve të tyre.</p> <p>Disa nga VKM mbështetëse për elementët e këtij program janë: <i>VKM nr.41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”;</i> <i>VKM nr.879, datë 18/12/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24/01/2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”;</i> <i>VKM nr.185, datë 25/03/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24/01/2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</i> <i>Shtojca nr. 91.2 VKM nr. 1055 dt. 29.07.2009 mbi licensimin e shlp logos; shtojca nr. 91.3 Urdher 396 për lejimin e ushtrimit të vepramtarisë së shlp LOGOS</i> <i>shtojca nr. 61.1 Vendimet e Bordit të Akredimit nr. 48</i> <i>shtojca nr. 61.2 VKA nr.388, dt.08.06.2012 Urdher MASH nr. 282 dt. 04.07.12</i></p>

	<p><i>Shtojcat nr.14.1, 14.2, 14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022; Shtojca nr.19.1: Syllabuset viti akademik 2019-2020, 19.2: Syllabuset viti akademik 2020-2021, 19.3: Syllabuset viti akademik 2021-2022).</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bsc Menaxhim Turizmi është një ndër programet e para të studimit që ka hapur Kolegji Universitar “LOGOS”. Akreditimet e marra në vitin 2012, 2019 dëshmojnë se Kolegji Universitar “LOGOS” ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programi studimi Bsc Menaxhim Turizmi.</p> <p>Ky program studimi ka ardhur duke u përmirësuar në cilësinë dhe e mësimdhënies, planin mësimor të ofruar në përputhje me kërkesat e tregut, angazhimin e stafit akademik me tituj dhe grada. Programi i studimit të ciklit të parë zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. Pikërisht bazuar në koherencën e KU Logos, në përpjekjet e vazhduara për të përmirësuar cilësisht cdo lloj program, <i>gjykojmë se departamenti do të maksimizojë përpjekjet për të realizuar përmirësimet në planin mësimor aktual.</i></p> <p><i>Pikërisht për të realizuar plotësimin e këtij kriteri është e nevojshme që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>të shtohet një lëndë bazë e turizmit që në vitin e parë,</i> • <i>në vitin e tretë të shtohen lëndët me zgjedhje si mundësi zgjedhjeje për studentët dhe diversifikim të njohurive të tyre. Këto lëndë të jenë lëndë të rëndësishme dhe koherente në botë, pra të bazuara në kurrikulat botërore, që janë trende sot në botë, etj.</i> <p>Në këtë mënyrë ky program studimi do të ofrojë njohuri të përparuara sipas fushës së turizmit së cilës i shërben, që përbën dhe sektorin kryesor të punësimit të të diplomuarve.</p> <p><i>Shtojca nr. 91.2 VKM nr. 1055 dt. 29.07.2009 mbi licensimin e shlp logos; Shtojca nr. 91.3 Urdher 396 per lejimin e ushtrimit te vepramtarise se shlp logos</i></p> <p><i>Shtojca nr. 61.1 Vendimet e Bordit të Akredimit nr. 48;</i></p> <p><i>Shtojca nr. 61.2 VKA nr.388, dt.08.06.2012 Urdher MASH nr. 282 dt. 04.07.12)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> <p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi përmban të dhëna të plota mbi:</p> <p>modulet/ lëndët që realizohen dhe ndarja në veprimtari, në forma të mësimdhënies dhe në orë individuale kryhet me synimin e formimit të shprehive të veçanta sipas karakteristikave të lëndës/ modulit. <i>Mungojne lendet me zgjedhje.</i></p> <p>syllabuset kanë informacion të plotë rreth përmbajtjes së çdo lënde, sipas strukturës së planit të studimit, për literaturën bazë dhe atë</p>

<p>veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>plotësuese, orët mësimore të parashikuara për secilën temë. <i>Sugjerohen shtime te literaturave te viteve te fundit.</i></p> <p>Syllabuset e lëndëve/ moduleve të këtij programi, përmbajnë shprehitë e njohurive të përparuara dhe për diskutimin, miratimin dhe zbatimin e tyre, ndiqet procedura e miratimit para fillimit të çdo viti akademik. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> <p>Përmbajtja e lëndëve, aktivitetet e formimit teorik e praktik janë të organizuara në mënyrë të tillë që të mundësojnë përvetësimin e koncepteve kyçe në kuadër të formimit në fushën e ekonomisë, drejtimin e menaxhimit të turizmit, zhvillimin e të menduarit kritik, aftësimin për gjetjen e zgjidhjeve në situata konkrete duke nxitur bashkëpunimin në grup si dhe orientimin cilësor në tregun e punës. Sikurse u tha edhe më lart është e nevojshme që të bëhen ndryshime cilësore dhe sasiore graduale në drejtim të përfshirjes së lëndëve që aftësojnë studentët me njohuri bazë të turizmit dhe klasifikimi apo përfshirja e këtyre lëndëve në grupet përkatëse të formimit dhe ofrimit të njohurive, e shoqëruar kjo dhe me peshën e orëve dhe të krediteve.</p> <p><i>Shtojca nr.7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi</i></p> <p><i>Shtojca nr.64: Procesverbal Departamenti i Menaxhimit miratimi i syllabuseve 2021-2022</i></p> <p><i>Shtojcat nr.14.1, 14.2, 14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022;</i></p> <p><i>Shtojca nr.19.1: Syllabuset viti akademik 2019-2020, 19.2: Syllabuset viti akademik 2020-2021, 19.3: Syllabuset viti akademik 2021-2022).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.2</p>	
<p>Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit, si njësi bazë e Fakultetit Ekonomik. Ky program është hartuar bazuar në Rregulloren e Përgjithshme të Kolegjit Universitar “LOGOS”, Statutin e Institucionit, dhe Rregulloren e Fakultetit Ekonomik. Bazuar në këto rregullore është formuar struktura e programit të studimit dhe kurrikula e tij.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit dhe njëkohësisht është përgjegjëse për ofrimin dhe mbarëvajtjen e këtij programi studimi, duke përmbushur detyrimet ligjore për vlerësimin</p>

	<p>dhe akreditimin. Departamenti përmbush kushtin e vënë nga akreditimi i mëparshëm për të plotësuar 70% të ngarkesës me staf të brendshëm.</p> <p>(Shtojca nr. 60: Organigrama e KU "LOGOS", Shtojca nr.2: Statuti i KU "LOGOS"; Shtojca nr.5: Rregullore e Përgjithshme e "KU LOGOS"; Shtojca nr.6: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit; Shtojca nr.7: Rregullore e Programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi; Tabela nr.12. Plani mësimor i lidhur me personelin akademik). Shtojca 18: plotësimi i rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë dhe/ose akreditimi i mëparshëm.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Në Vendimin nr.25, datë 25.09.2021 i Dekanit FE për caktimin e Koordinatorëve sipas programit të studimit, pika 1 dhe 2 e këtij vendimi përcakton pedagogët koordinorë përkatësisht sipas programeve dhe njësisë kryesore. Veprimtaria e tyre rregullohet mbi bazën e Rregullores për Udhëheqje/ kujdestari (tutorat) për studentët e KU LOGOS. E caktuar në mënyrë të rregullt dhe procedurale, njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton koordinatorin e programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij, dhe që informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p> <p>Shtojca nr.36.1: KU LOGOS 2021 Vendimi nr.25, datë 25.09.2021 i Dekanit FE për caktimin e Koordinatorëve sipas programit të studimit Shtojca nr.36.3: Rregullore Udhëheqje kujdestari (tutorat) për studentët e KU LOGOS Shtojca nr.36.2: Procesverbal takimi i tutoratit për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Në vitin 2018 në strukturën organizative të Kolegji Universitar "LOGOS" shtohet njësia kryesore Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, i cili ka në përbërje të tij tre Departamente. Fakulteti Ekonomik në vitin 2019 bëri një riorganizim të strukturës së tij duke u riorganizuar në tri departamente (Shtojca 91.8):</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Departamenti i Financë-Kontabilitet, ● Departamenti i Menaxhimit, ● Departamenti i Agrobiznesit <p>Në Departamentin e Menaxhimit u përfshi programi i studimit Bachelor "Menaxhim Turizmi", i cili u ri-akreditua me Vendim të Bordit Akreditimit Nr. 48, datë 05.07.2019, për një periudhë tre vjeçare. Misioni dhe objektivat e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është në përputhje edhe me priroritet e planit strategjik Institucional si "Përmbushja e Standardeve Akademike; Kërkimit; Parteneritetit", me qëllim përsosmërinë dhe përditësimi e kurrikulës, programeve mësimore, kërkimi shkencor, krijimin dhe</p>




	zhvillimin e marrëdhënieve të partneritetit me punëdhësit sipas nevojave të tregut <i>Shtojca nr.3: Plani Strategjik i KU "LOGOS", 2018-2024, prioritet 2,3,4</i>			
Kriteri 4. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Njësia kryesore dhe bazë organizohet në bazë të marrëveshjes ndërmjet MASR dhe Kolegjit Universitar "Logos" duke përmbushur detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, neni 3, pika 2: numri i personelit akademik me kohë të plotë në njësinë bazë, është 5, nga të cilët 2 janë me grada. <i>Shtojca nr.58: Marrëveshje MASR, Reduktimi i numrit të personelit akademik</i> <i>Shtojca: Grup tabelat 1.1-1.4</i> <i>Shtojca nr.7: Rregullore e Programit të studimit Bsc. "Menaxhim Turizmi", neni 4 dhe 10</i> <i>shtojca 14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. Menaxhim Turizmi;</i> <i>Shtojca nr. 20: CV e stafit akademik të programit të studimit</i>			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm të konsultuar, njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, dhe përmbushur detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Kështu, sigurohet që: <ul style="list-style-type: none"> • numri i personelit akademik me kohë të plotë në njësinë bazë, është 5, nga të cilët 2 janë me grada dhe neni 3, pika 4; • ngarkesa mësimore e stafit akademik me kohë të plotë është më shumë se 70% e ngarkesës mësimore totale . • Njësia kryesore drejtohet nga Dekani që zotëron titullin Prof.Dr. dhe njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, drejtohet nga përgjegjësja e departamentit që zotëron gradën Dr. <i>Shtojca nr.58: Marrëveshje MASR, Reduktimi i numrit të personelit akademik</i> <i>Shtojca: Grup tabelat 1, grup tabelat 6 dhe grup tabelat 12</i> <i>Shtojca: Grup tabelat 4.1-4.4: Ngarkesa totale e personelit akademik sipas programeve në një vit akademik</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret


Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Njësia bazë që ofron programin e studimit bachelor në “Manaxhim Turizëm” e cila është përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p> <p>Kjo është e konfirmuar jo vetëm nga dokumentacioni i vënë në dispozicion por vecanërisht nga identifikimi dhe funksionimi i të gjitha hallkave mbështetëse të njësisë bazë, që mundësojnë funksionalitetin e kësaj njësie duke plotësuar në këtë mënyrë të gjithë objektivat e programit. Syllabuset e plota, përmbajtja e detajuar me anekse dhe tabela të shumëllojshme dhe sqaruese, raportet dhe strategjitë e institucionit dhe të njësisë bazë që e ofron demonstronë përkushtimin e stafit të brendshëm dhe atij administrative, vëmendjen dhe mbështetjen e dhënë që nga drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore e tek drejtuesit e KU Logos.</p> <p><i>Shtojca nr.81.3: Materialet dhe broshurat informuese për studentin, Fletëpalosja dhe Broshura e KU “LOGOS” në shqip</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është i organizuar në lëndë, të vlerësuara me kredite, jo më pak se 180 kredite sipas sistemit vendas e evropian, të ndara në 3 vite akademike me nga dy semestra. Çdo vit mësimor është i organizuar në 60 kredite. Ndarja sipas kategorive është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë - 18.3% ECTS - Lëndë karakterizuese - 50% ECTS - Lëndë ndërdisiplinore - 14.2 % ECTS - Lëndë plotësuese - 14.2% ECTS - Detyrime përmblylëse - 3.3 ECTS <p>Me reflektimet e nevojshme të ofruara nga ky raport vlerësimi, në strukturën e lëndëve do të përfshihen edhe shporta e lëndëve me zgjedhje, jo vetëm si detyrim por edhe mbështetëse për studentët të përzgjedhin lëndë sipas preferencave dhe orientimeve të tyre.</p> <p><i>Shtojca nr.14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2021-2022</i></p> <p><i>Tabela nr.10</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Sipas rekomandimeve të dhëna në akreditimin e mëparshëm institucioni, të rishikojë planin mësimor të këtij programi studimi me qëllim shtimin e lëndëve të karakterit menaxherial dhe integrimin e detyrave të kursit dhe detyrimeve të tjera gjatë vitit në vlerësimin përfundimtar. KU Logos e ka plotësuar kete duke përmirësuar planin mesimor dhe kete kriter. Keshtu: “Institucioni e vlerësoi të rëndësishëm këtë rekomandim të bërë, dhe ka përmirësuar ndjeshëm prezencën e lëndëve të karakterit menaxherial dhe formues në planin mësimor. Plani mësimor i programit Bachelor në “Menaxhim Turizmi” i vitit 2019-2020 përmban lëndët e karakterit menaxherial, lëndë rezultat i hulumtimit të bërë në nevojat e tregut për formimin e studentit të këtij programi, si dhe lëndë të shtuara nga konsultimi i bërë me universitete me të cilat kemi marrëveshje e bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit”. Ky program studimi përmban te gjithë</p>

	<p>elementet qe nga plani mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. Ndarja e orëve mësimore në auditor me orë për leksione, orë seminare, orë ushtrime, orë laborator për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, bazuar në numrin e krediteve të çdo disipline. Çdo kredit i korrespondon 25 orë mësimore pune të studentit.</p> <p><i>Shtojca Tabela nr.10</i> <i>Shtojca nr.7 Rregullore e programit të studimit Bsc në Menaxhim Turizmi, Neni 8, 9, 10, 11, 12;</i> <i>Shtojca nr.14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Bsc Menaxhim Turizmi është një ndër programet e para të studimit që ka hapur Kolegji Universitar “LOGOS”. Akreditimet e marra në vitin 2012, 2019 dëshmojnë se Kolegji Universitar “LOGOS” ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e programi studimi Bsc Menaxhim Turizmi. Ky program studimi ka ardhur duke u përmirësuar në cilësinë dhe e mësimdhënies, planin mësimor të ofruar në përputhje me kërkesat e tregut, angazhimin e stafit akademik me tituj dhe grada. Në këtë program studimi përfshihen të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Programit i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, i referohet nivelit të 6-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe organizohet me 180 kredite europiane (ECTS). Transferimi dhe ekuivalentimi bëhet dhe mbi bazën e Rregullorës së Transferimeve të Kolegjit Universitar “LOGOS”.</p> <p><i>Shtojca nr.80.1: Vendim Senati nr.9, datë 13.02.2019 për Miratimin e Kriteve të pranimit të studentëve për programet e studimit që Kolegji Universitar “LOGOS” ofron për vitin akademik 2020-2021</i> <i>Shtojca nr.80.1.2: Vendim Senati nr.9.1, datë 13.02.2019 për Kuotat e studimit parashikuar nga Kolegji Universitar “LOGOS” nga 2017-2020 lidhur me studentët e kategorive sociale të veçanta;</i> <i>Shtojca nr.85.1: Rregullore e transferimeve;</i> <i>Shtojca nr.85.2: Vendim Dekanati FE nr.1, datë 02.09.2019 Për ngritjen e Komisionit për transferimet;</i> <i>Shtojca nr.85.3: Praktikë e plotë mbi transferimin e studentëve</i> <i>Shtojca nr. 91.2 VKM nr. 1055 dt. 29.07.2009 mbi licensimin e shlp logos;</i> <i>shtojca nr. 91.3 Urdher 396 per lejimin e ushtrimit te vepramtarise se shlp logos,</i> <i>shtojca nr. 61.1 Vendimet e Bordit të Akreditimit nr. 48; shtojca nr. 61.2 VKA nr.388, dt.08.06.2012 Urdher MASH nr. 282 dt. 04.07.12)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe</p>	<p>Është e dukshme se vëmendja ndaj këtij programi studimi është relativisht e madhe, kjo vihet re jo vetëm në përpjeket që reflektohen</p>

<p>përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>që nga stafi e deri tek drejtuesit e të gjitha njësive, por nga dokumentacioni, raportet, strategjitë, dhe vecanërisht takimet në institucion me të gjithë grupet e interesit. Kështu, të gjitha sugjerimet që përmban ky raport vlerësimi janë konsultuar dhe dakortësuar me aktorët përkatës në institucion, duke gjykuar dhe format konkrete të përmirësimit të programit planit mësimor, syllabuseve apo stafit dhe metodave mësimdhënëse. Plani mësimor aktual është përmirësuar duke plotësuar rekomandimet e lëna nga Raporti i Vlerësimit të Jashtëm dhe Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 48, Datë 05.07.2019 “Për Akreditimin Periodik të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Menaxhim Turizmi”, të Kolegjit Universitar “Logos” dhe është miratuar në vitin 2019 <i>Shtojca nr.57: Vlerësim punëdhënësi për ALUMNI;</i> <i>Shtojca nr.57.1: Formular Alumni,</i> <i>Shtojca nr.52: Shkresa derguar MASR per ndryshimet 20 % 08.04.2019; Shtojca nr.61: Vendimet e Bordit të Akreditimit nr. 48;</i> <i>Shtojca nr.14.1: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2019-2020,</i> <i>Shtojca nr.14.2: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2020-2021,</i> <i>Shtojca nr.14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2021-2022).</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="655 1003 855 1077">Përmbushje t pjesërisht</th> <th data-bbox="855 1003 1023 1077">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1023 1003 1233 1077">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="655 1077 855 1120"></td> <td data-bbox="855 1077 1023 1120"></td> <td data-bbox="1023 1077 1233 1120">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushje t pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushje t pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi organizohet nëpërmjet planit mësimor, në zbatim të VKM nr.41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; VKM nr.879, datë 18/12/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24/01/2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; VKM nr.185, datë 25/03/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24/01/2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Lektorët kanë fushën e tyre të kërkimit në përputhje me drejtimin e programit e për rrjedhojë, njohuritë dhe aftësitë e fituara nga puna kërkimore individuale përcillen nëpërmjet materialeve që përdoren në procesin mësimor.</p> <p>Kurrikula (Tabela nr.10) është e shpërndarë për 3 vite akademike me nga 60 ECTS për secilin vit akademik, që ngarkohet jo më pak se 1500 orë totale, çdo semestër zgjat 15 javë.</p>



	<p><i>Shtojca nr.7: Rregullore e programit të studimit Bsc Menaxhim Turizmi,</i> <i>Shtojca nr.83: Kalendari Akademik 2021-2022;</i> <i>Shtojca nr.14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizëm 2021-2022</i> <i>Shtojca nr.20: CV e Stafit Akademik të programit të studimit</i> <i>Tabela 10 e Kurrikulave</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ ose punësim të studentëve.</p>	<p>Të gjithë elementët bazikë që përmban një program studimi që nga strategjitë e programit e deri në planet mësimore, janë në lidhje dhe korelacion të drejtë me njëra tjetrën, i shërbejnë plotësisht të misionit të përgjithshëm të institucionit, programit dhe qëllimit të tij, duke plotësuar të gjithë objektivat e vëna.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dhëna të plota mbi modulet/ lëndët që realizohen dhe ndarja në veprimtari, në forma të mësimdhënies dhe në orë individuale kryhet me synimin e formimit të shprehive të veçanta sipas karakteristikave të lëndës/ modulit. - Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ ose punësim të studentëve - Gjithashtu, syllabuset kanë informacion të plotë rreth përmbajtjes së çdo lënde, sipas strukturës së planit të studimit, për literaturën bazë dhe atë plotësuese, orët mësimore të parashikuara për secilën temë. <p><i>Shtojcat nr.14.1, 14.2,</i> <i>14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022;</i> <i>Shtojca nr.19.1: Syllabuset viti akademik 2019-2020, 19.2: Syllabuset viti akademik 2020-2021, 19.3: Syllabuset viti akademik 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësisht profesional.</p> <p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Elementët e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi organizohen në përputhje me VKM nr.41, datë 24/01/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; VKM nr.879, datë 18/12/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24/01/2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; VKM nr.185, datë 25/03/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24/01/2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.</p> <p>Plani mësimor i Programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi për vitin 2021-2022, siguron një shpërndarje të lëndëve mësimore në lëndë bazë (33 kredite ose 18.3%), lëndë karakterizuese (90 kredite ose 50%), lëndë ndërdisiplinore (25,5 kredite ose 14.2%), dhe lëndë plotësuese (25.5 kredite ose 14.2%), si edhe detyrime përmbyllëse (6 kredite ose 3.3 %), duke përcaktuar me detaje fushat disiplinore, si dhe kreditet përkatëse për çdo lëndë. Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi organizohet në përputhje me nenin 73 të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dt.22/07/2015. Programi i studimit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë


E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 26

	<p>Bachelor në Menaxhim Turizmi, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, ofrohet me jo më pak se 180 kredite (ECTS), me një kohëzgjatje normale prej tre vitesh akademike. Në përfundim të këtij cikli, studentët pajisen me diplomë Bachelor në Menaxhim Turizmi.</p> <p><i>Është theksuar edhe më lart që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Rekomandohet të shtohet 1 lëndë bazë e turizmit që në vitin e parë. - Të shtohet shporta e lëndëve me zgjedhje në vitin e tretë. Studenti duhet të ketë në kurrikulën e tij të paktën 2 lëndë me zgjedhje. <p>Me organizimin e mësipërm të strukturës së planit mësimor, të përfshirjes së lëndëve të formimit bazë në turizëm që në vitin e parë, dhe totalisht në vitin e tretë, duke shtuar lëndë me zgjedhje më pak kredite, do të mundet që të plotësohet ky kriter.</p> <p><i>Shtojca nr.14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizëm 2021-2022</i></p> <p><i>Shtojca nr.61: Vendim Bordi i Akreditimi Nr. 48, Datë 05.07.2019 “Për Akreditimin Periodik të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, Bachelor në “Menaxhim Biznesi/Turizmi”, të Kolegjit Universitar “Logos”</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ky program studimi është i organizuar në lëndë, praktika e aktivitete formuese, duke bërë të mundur:</p> <ul style="list-style-type: none"> - arritjen e rezultateve të të nxënit, - transferimin e studimeve nga një degë apo institucion në tjetrin, të dhëna këto që janë të detajuara në kurrikulën dhe Rregulloren e programit të studimit. - Shpërndarja e lëndëve në kurrikul synon lehtësimin e aritjeve të rezultateve të të nxënit të programit të studimit. - raportet gradualisht zhvendosen nga teoria e kombinuar me praktikën drejt praktikës së informuar prej teorisë dhe synojnë aftësimin profesional të studentëve.
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Në bazë të VKM të mëposhtme mundësohet plotësimi i këtij kriteri duke mundësuar që programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në zbatim të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruara nga Institucionet e arsimit të lartë, të ndryshuar”; - VKM nr.879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018, të këshillit të ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; - VKM nr.185 datë 25.03.2021” Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga



	institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar ka përditësuar literaturë të detyruar dhe ndihmëse për 5 viteve të fundit.		
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi përmban të dhëna të plota mbi modulet/ lëndët që realizohen dhe ndarja në veprimtari, në forma të mësimdhënies dhe në orë individuale kryhet me synimin e formimit të shprehive të veçanta sipas karakteristikave të lëndës/ modulit. Gjithashtu, syllabuset kanë informacion të plotë rreth përmbajtjes së çdo lënde, sipas strukturës së planit të studimit, për literaturën bazë dhe atë plotësuese, orët mësimore të parashikuara për secilën temë. <i>Shtojcat nr.14.1, 14.2, 14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2019-2020; 2020-2021, 2021-2022; Shtojca nr.19.1: Syllabuset viti akademik 2019-2020, 19.2: Syllabuset viti akademik 2020-2021, 19.3: Syllabuset viti akademik 2021-2022</i>		
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ky program studimi përbën një qasje aktive dhe një përpjekje të sukseshme për të qënë sa më pranë kërkesave të tregut të punës dhe punësimin të studentëve sipas profilit të diplomës së tyre bachelor. Me rekomandimet e sugjeruara vijueshmëria e punësimin apo edhe e studimeve të tyre si brenda ashtu edhe jashtë vendit do të ofrojë pritshmëri edhe më të mëdha kundrejt kërkesave në rritje të tregut. Departamenti i Menaxhimit, për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit, ka nje qasje mjaft aktive: kryen takime me institucionet që ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, zhvillon intervista me pedagogët dhe anketa me studentët për të vjelur sugjerimet përkatëse rreth programit të studimit për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. Departamenti, gjithashtu bashkëpunon ngushtë edhe me Zyrën e Këshillimit dhe Çështjeve Studentore për marrjen e feedback-ut nga Alumni për analizën e përshtatshmërisë së programit të studimit me vendin dhe punës dhe merr sugjerimet përkatëse. <i>Shtojca nr.17:3 Të dhëna për punësimin e studentëve; Shtojca nr.57: Vlerësim punëdhënësi për ALUMNI; Shtojca nr.57.1: Formular Alumni. Shtojca nr.7: Rregullore e programit të studimit Bsc Menaxhim Turizmi, neni 4; Shtojca nr.17.3: Të dhëna për punësimin e studentëve</i>		
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Stafi Akademik, i angazhuar në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizëm, ka kualifikimin e duhur me grada shkencore sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në përputhje me formimin e tyre shkencor. Departamenti i Menaxhimit për vitin akademik 2021-2022 ka të angazhuar 5 staf akademik me kohë të plotë (3 staf akademik me titull Doktor, 2 Asistent-lektorë me titull Msc.), dhe 11 staf akademik me kohë të pjesshme (1 staf akademik me titull Profesor Doktor, 3 staf akademik me titull Prof. Asoc., 4 staf akademik me titull Doktor, 3 staf akademik me titull Msc.</p> <p>Për vitin akademik 2019- 2020 janë angazhuar gjithsej 28 staf, 17 PAE dhe 14 PAK</p> <p>Për vitin akademik 2020- 2021 janë angazhuar gjithsej 28 staf, 14 PAE dhe 13 PAK</p> <p>Për vitin akademik 2021- 2022 janë angazhuar gjithsej 28 staf, 15 PAE dhe 13 PAK.</p> <p><i>Shtojca Tabela nr. 1, 2, 6.6;</i></p> <p><i>Shtojca nr.20: CV e stafit akademik të programit të studimit;</i></p> <p><i>Shtojca nr.58: Marreveshje MAS, Reduktimi i numrit të personelit akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Menaxhimit. Fakulteti Ekonomik në përbërje të tij ka tre departamente, dhe Departamenti i Menaxhimit bashkëpunon ngushtë me këto departamente. Departamenti i Menaxhimit ofron edhe programin Bachelor në Menaxhim Biznesi, fusha akademike dhe kërkimore e të cilit plotëson programin e Menaxhim Turizmit në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për menaxhimin e biznesit turistik.</p> <p>Nga ana tjetër, Departamenti i Financë- Kontabilitetit kontribuon në fushën akademike dhe kërkimore për plotësimin e njohurive financiare të një Menaxheri Turizmi. Gjithashtu, veprimtaria kërkimore e personelit akademik është në përputhje me kurrikulën e programit të studimit.</p> <p>Po kështu edhe stafi i jashtëm që është prej shumë kohësh në këtë status, pra si pedagogë të jashtëm pranë këtij programi, përbëjnë ekspertë të fushës, sidomos nga institucionet publike vendimarrëse që mjaft mirë sjellin shembujt konkrete të praktikave më të mira të vendit, por jo vetëm. Një miksim i tillë midis stafit të jashtëm u krijon mundësi atyre që t'u gjenden shumë më pranë institucionit dhe fakultetit për të përmirësuar sasinë dhe cilësinë e këtij program studimi. Këto sugjerime dhe rekomandime u ndanë edhe me stafin (brendshëm dhe të jashtëm) gjatë vizitës në institucion, me drejtuesin e departamentit dhe të njësisë kryesore. Vihet re një përkushtim mjaft cilësor i drejtuesit të departamentit dhe të gjithë stafit të brendshëm në të gjithë procesin, duke e bërë më të prekshëm vlerësimin por edhe më të pranueshme ndarjen e shqetësimeve të përbashkëta për vijueshmërinë cilësore të këtij program studimi.</p>

	<p><i>Shtojca nr.14.3: Plani mësimor i programit të studimit Bsc. në Menaxhim Turizmi 2021-2022;</i></p> <p><i>Shtojca Tabela nr.4. Shtojca nr.43: Të dhënat për kualifikime kërkim shkencor për 5 vitet e fundit</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Menaxhimit. Sipas specifikave të këtij programi studimi sugjerohet që të jenë totalisht në përputhje formimi bazë i pedagogut me lëndët brenda programit në menaxhim turizëm, sikurse të shtohet numri i stafit të brendshëm mësimdhënës në vitin e tretë. Pra, me reflektimin e sugjerimeve që përmban ky raporti i Vlerësimit të Jashtëm, me shtimin e lëndëve të turizmit, me afrimin e lëndëve që në semestrin e parë të vitit të parë, do të jetë më e nevojshme prezenca e stafit të brendshëm në mësimdhënie se sa përqëndrimi i të gjithë stafit të jashtëm mësimdhënës në një vit të tërë dhe të vetëm akademik ku ofrohen lëndë të turizmit, pra të profilit të programit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Menaxhimit. Stafit akademik i angazhuar në Departamentin e Menaxhimit është i kualifikuar, dhe merr pjesë në mënyrë aktive në veprimtari kërkimore-shkencore, shprehur në publikime/ pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me fushën akademike e kërkimore të programit të studimit. Përgjatë periudhës së mësimdhënies online, veçojmë organizimet e aktiviteve shkencore me pedagogët e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi si Webinarin me temë “E nesërmja e turizmit shqiptar”, në fokus të sëcilit ishte efektet e Covid-19 mbi sektorin turistik. Këto aktivitete janë tregues të rëndësishëm të transferimit të njohurive të fushën akademike kërkimore dhe bashkëkohore gjatë procesit të mësimdhënies në lëndët që stafi akademik i Departamentit të Menaxhimit mbulon për programin e studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi. I gjithë procesi mësimor mbështetet fort nga një administratë e cila e organizuar mjaft mirë në njësi të strukturuar mirë, përcakton qartë se kush të bëjë çfarë, por edhe studentët çfarë të kërkojnë dhe ku. E gjithë kjo e organizuar në një zinxhir të tillë që vetëm shton vlerën njësisë bazë, dhe rrjedhimisht programit të studimit dhe cilësisë së mbarëvajtjes së tij.</p> <p>Departamenti i Menaxhimit vë në dispozicion personelin e duhur e të kualifikuar, të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale.</p> <p>Raporti pedagog/ student për këtë program studimi është shumë i favorshëm për studentin. Praktika profesionale zhvillohet pranë kompanive të biznesit me të cilat Kolegji Universitar “LOGOS” ka marrëveshje dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga Departamenti i Fakultetit Ekonomik (Shtojca nr.68: Ndjekja e studentëve për diplomim; Shtojca nr.73: Dosje e plotë e praktikës</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	

	profesionale studenti programi i studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi). <i>Shtojca nr.59.1: Webinari; Shtojca nr.43: Të dhënat për kualifikime kërkim shkencor për 5 vitet e fundit</i> <i>Shtojca nr.20: CV e Stafit Akademik të programit të studimit; Shtojca Tabela nr.19, 20</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p> <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Kolegji Universitar “LOGOS” ka si mision “Të zhvillojë dijet, përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor, në të mirë të përgatitjes me nivel bashkohor të studentëve, të ofrojë mundësi të mira për të përfutur nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit, të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor”. (Shtojca nr.2: Statuti i KU “LOGOS”, neni 4; Shtojca nr.:5 Rregullore e Përgjithshme e KU “LOGOS”). Për të mundësuar misionin dhe realizuar objektivat në mbështetje të misionit, institucioni ka hartuar mekanizma dhe udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Sic u tha edhe me lart, është krijuar një strukturë e tërë e njëjësive që shoqërojnë studentin që në hyrje e deri pas diplomimit, që tërheqin vlerësimet e herëpashershme të studenteve për procesin mësimor dhe mësimdhënien duke mbledhur në mënyrë etike të gjithë informacionin, transmetuar në zyrat përkatëse dhe bërë me dije në fund njësisë bazë. Kështu, nëpërmjet Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Cilësisë, Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionit të Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët, institucioni ndjek dhe vlerëson në mënyrë periodike në bashkërendim me njësinë bazë dhe atë kryesore, aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p><i>Shtojcat nr.39.1-39.8. Udhëzuesit janë dokumentuar në gjuhën shqipe dhe angleze dhe janë vendosur në faqen web të institucionit. (Link: http://www.kulogos.edu.al/al/distance-learning.html)</i></p> <p><i>Shtojca nr.66.1), Urdhërin e përbashkët të autoriteteve drejtuese të Kolegjit Universitar Logos nr.2, datë 27.01.2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Zyrën e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, e cila bashkëpunon me Departamentin e Menaxhimit për krijimin e bazës së të dhënave me sugjerimet përkatëse nga rrjeti Alumni dhe punëdhënësit e studentëve. Mbi këtë bazë të dhënash Departamenti rishikon, dhe përmirëson kurrikulën e programit të studimit dhe i ofron tregut të punës një program studimi më konkurrues.</p> <p><i>Shtojca nr.17: Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve; 17.3 Të dhëna për punësimin e studentëve;</i></p> <p><i>Shtojca nr.7: Rregullore e programit të studimit Bsc në Menaxhim Turizmi, neni 39, 40, 41;</i></p> <p><i>Shtojca nr.52: Shkresa dërguar MASR për ndryshimet 20 % 08.04.2019).</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e</p>	<p>Në këtë kuadër, Kolegji Universitar “LOGOS” ka krijuar struktura si Komisioni i Përhershëm i Garantimit dhe Sigurimit të Cilësisë së</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


Faqe 32

<p>cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Institucionit dhe Programeve të Studimit' dhe Njësinë e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë si dhe një sërë dokumenta mbështetëse, të cilat mbështetën tek Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Manualin e ASCAL për vlerësimin institucional dhe të programeve të studimit (Shtojca nr.13: Politika për sigurimin e Cilësisë; Shtojca nr.8: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë). Departamenti i Menaxhimit në bashkëpunim me NJSBC e Institucionit vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi. Departamenti i Menaxhimit ushtron lirinë e tij akademike për përmirësimin e programit të studimit bazuar konform legjislacionit, Statutit, Rregullores së Kolegjit Universitar "LOGOS" dhe Rregullores së Programit të studimit Bsc në Menaxhim Turizmi (Shtojca nr.8: Rregullore për Sigurimin e Cilësisë; Shtojca nr.6: Rregullore e Departamentit të Menaxhimit, neni 38).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Rezultatet e procesit të mesipërmbëhen pjesë e raportit institucional, i cili miratohet me vendime të Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit dhe paraqitet në Minsitrinë e Arsimit në përmbushje të detyrimeve të KU Logos. Nga diskutimet në institucion, promovimi i shembujve dhe praktikave të mira për nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies janë diskutuar, zbatuar dhe bërë publike në njësinë bazë dhe atë kryesore dhe për këtë janë organizuar edhe takime me studentët për të kuptuar rolin dhe vlerën e këtyre praktikave. Shtojcat nr.59.1, 59.2, 59.3, 59.4: webinar, workshop, tryeza të rrumbullakëta, leksione të hapura). Shtojca nr.65.1: Raporti institucional 2019-2020, Shtojca nr.65.2: Raporti institucional 2020-2021</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>E reflektuar edhe në planin mësimor, e detajuar dhe shpjeguar në syllabuse në mënyrë korrekte, e diskutuar edhe gjatë vizitës në institucion, me të gjitha grupet e interesit rezultojn se leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni përbëjnë format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive. Është mjaft interesante, e vecantë dhe e konsideruar cilësore, aftësimi praktik që studentët bëjnë për njohuritë e marra. Mësimnxënja transmetohet paralelisht edhe me orë laboratorike në terren, me prani të specialistëve të fushës në mënyrë periodike, me një qasje mjaft aktive jo vetëm të bizneseve të turizmit në tregun shqiptar</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u</p>	



<p>përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>por edhe te ekspertëve të huaj të pranishëm në mësimdhënie. Gjithsesi edhe bazuar në rregulloren e këtij program studimi, personeli akademik respekton diversitetin dhe ju përgjigjet nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi. Personeli akademik ofron konsultime përgjatë semestrave dhe në fund të tyre; format e testimit janë me shkrim dhe me gojë. Një integrim i metodave të tilla mësimdhënëse është reflektuar jo vetëm nga dokumentacioni por nga të gjitha diskutimet me stafin mësimdhënës dhe atë drejtues. E pranuar edhe nga studentët dhe e vlerësuar si një formë positive, kjo ka ndikuar që ky kombinim të testohet dhe vlerësohet si i suksesshëm. Kjo përbën në këtë mënyrë një instrument që institucioni garanton aftësimin e studentëve dhe kombinimin e njohurive të marra me konkretizimet në praktikë.</p> <p><i>Shtojcat nr.59.1, 59.2, 59.3, 59.4, 59.5, 59.6: webinar, workshop, tryeza të rrumbullakëta, leksione të hapura, konferenca studentore</i></p> <p><i>Shtojca nr.7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Ajo cka u shpjeguar në pikën e mësipërme lidhet pikërisht me faktin e lirisë akademike që institucioni KU Logos ka respektuar në mbështetje të Ligjit të Arsimit të lartë por edhe të politikave të veta transparente dhe në rritje të cilësisë. Ky institucion dallon në koherencën dhe qëndrueshmërinë e programit pikërisht edhe në ofrimin e metodave innovative, fleksibile, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues. Këto forma janë në përmirësim të vazhdueshëm dhe për këtë stafi akademik është pjesë e trajnimeve në kuadër të programit Erasmus, me prani fizike dhe online. Edhe gjatë vizitës dy ditore në institucion, stafi shprehet qartë në mbështetjen që institucioni ka dhënë pikërisht në këtë drejtim. E gjitha kjo gjë përveç se lirisë akademike, përmirësimit të cilësisë, ka sjellë edhe rritjen paralele në kompetenca në shpjegimin e njohurive e koncepteve, e rezultuar sigurisht edhe përmes përdorimit të metodave të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p> <p><i>Shtojca nr.79: Trajnime nga Institucioni për mësimdhënien; Shtojca nr.63.3: Staff Mobilit</i></p> <p><i>Grup-tabelat 1.1-1.4 dhe 2.1-2.12</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Diskutimi me studentët gjatë vizitës në institucion reflektoi qëndrimin mjaft pozitiv të tyre për përfshirjen e tyre, të marrjes së cdo lloj opinionit apo vlerësimi qoftë me shkrim përmes pyetësorëve ose pa shkrim. Por studentët janë gjithnjë pranë stafit, stafi është pranë jo vetëm më ripërtëritjen e metodologjive mësimdhënëse por edhe në përditshmërinë e problematikave apo të të cdo lloj opinion të studentëve. Pyetësorët semestralë realizohen nga departamenti dhe nga NJSBC dhe rezultatet e vlerësuara nga Departamenti dhe Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, shërbejnë si pikënisje për punën e vitit të</p>

	ardhshëm akademik, në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të punës akademike, mësimore dhe përfshirjes së studentëve <i>Shtojca nr.40: Pyetësi i studentëve;</i> <i>Shtojca nr.41: Pyetësi i stafit akademik dhe ndihmës akademik</i> <i>Shtojcat nr.38.1 dhe 38.2: Raporti vjetor i Departamentit të Menaxhimit 2019-2020 dhe 2020-2021</i>		
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p> <p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik respekton diversitetin dhe ju përgjigjet nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi. Format dhe metodat e mësimdhënies jo vetem inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, por sigurojnë në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. Personeli akademik ofron konsultime përgjatë semestrave dhe në fund të tyre; format e testimit janë me shkrim dhe me gojë. Nevojat e studentëve fokusohen në preferencën për përzgjedhjen e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi kur kalojnë në vitin e tretë të studimeve; në përzgjedhjen e temave për realizimin e detyrave të kursit sipas lëndëve përkatëse; në prirjen dhe interesin për nënfusha studimi, të cilat ndikojnë në përzgjedhjen e temave të diplomave dhe dëshirat për të vazhduar studimet në ciklin Master. Studentët cilësojnë se reflektimi i temave të caktuara edhe në detyrat e kursit apo projektet e tyre individuale përbën një mënyrë të qasjes së mësimdhënies me mësimnxënies, duke siguruar një interaktivitet të metodologjisë së mësimi me atë cka reflekton studentin në praktikë nga njohuritë e përfuara.</p> <p><i>Shtojcat nr.67.2 dhe 67.3: Detyra kursi të realizuara</i> <i>Shtojca nr.7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi, neni 24</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me</p>	<p>Një ndër pikat e forta të ofrimit të këtij program studimi është infrastruktura e bollshme që reflekton një frymë të fortë akademike dhe në mbështetje totale ndaj stafit dhe studentëve. E identifikuar jo vetëm nga dokumentacioni por edhe gjatë vizitës në terren, kjo u shoqërua dhe me komente pozitive edhe mbështetëse të studentëve dhe vetë stafit. Funksionaliteti i ambienteve dhe përshtatja e tyre sipas llojit të shërbimit të ofruar është e shoqëruar paralel me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al



Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 35

<p>logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Është një staf i tërë që kujdeset për logjistikën, teknologjinë dhe realizueshmërinë normale të procesit mësimor por edhe atij kërkimor. <i>Shtojca: Tabela Përmbledhëse nr.16;</i> <i>Shtojca nr.42: Dokumentacioni në lidhje me infrastrukturën e KU LOGOS). Për Fakultetin Ekonomik, sipërfaqja për student është rreth 14 m².</i> <i>Shtojca: Tabela Përmbledhëse nr.16</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, si edhe studentët shfrytëzojnë sistemet informatike Microsoft Office 365, EduPage, Google Classroom, Google Meet, Zoom, bazuar në urdhër nr. 10, datë 22.03.2020 për përdorimin e platformës digjitale për mësimin në distancë, lidhja 2: tabela për mënyrën e zhvillimit të mësimin, laboratorëve, praktikave dhe provimeve, udhëzuesin për mësimin në distancë për studentët. Urdhërin e përbashkët të autoriteteve drejtuese të Kolegjit Universitar Logos nr.2, datë 27.01.2021 për zhvillimin e aktivitetit akademik me studentët nëpërmjet platformës microsoft teams. Udhëzuesit përkatës janë përgatitur për stafin akademik dhe për studentët dhe janë kryer trajnime për përdorimin e platformave Microsoft Office 365 dhe Edupage. Udhëzuesit janë dokumentuar në gjuhën shqipe dhe angleze dhe janë vendosur në faqen Web të institucionit. <i>(Link: http://www.kulogos.edu.al/al/distance-learning.html)</i> <i>Shtojca nr.66.2</i> <i>Shtojcat nr.39.1-39.8</i> <i>Shtojca nr.66.1</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p> <p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> <p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të gjitha strukturat dhe infrastrukturën e duhur për të garantuar marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Kështu, instrumentat e përdorur për ndërtimin dhe pasurimin e kurrikulës bazohen në përvojat kombëtare dhe ndërkombëtare, studimet mbi prirjet e zhvillimeve në fushat përfshirëse të programit, si edhe komunikimi i vazhdueshëm me partnerët të turizmit, dhe mundësojnë përmbajtjen e kurrikulës me larmishmëri dhe mënyrat e mësimdhënies e vlerësimit që parashikojnë zhvillimin e aftësive të transferueshme, më të cilat studentët janë në gjendje të përshtaten në mjedise të ndryshme punësimi. Përmbajtja e lëndëve, aktivitetet e formimit teorik e praktik janë të organizuara në mënyrë të tillë që të mundësojnë përvetësimin e koncepteve kyçe në kuadër të formimit në fushën e ekonomisë, drejtimin e menaxhimit të turizmit, zhvillimin e të menduarit kritik, aftësimin për gjetjen e zgjidhjeve në situata konkrete duke nxitur bashkëpunimin në grup si dhe orientimin cilësor në tregun e punës. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike). <i>Shtojca nr.19.1: Syllabuset viti akademik 2019-2020</i> <i>Shtojca nr 19.2: Syllabuset viti akademik 2020-2021</i> <i>Shtojca nr 19.3: Syllabuset viti akademik 2021-2022</i></p>


fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	<i>Shtojca nr.7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi</i>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga ana e KU Logos është përgatitur dhe vënë në përdorim platforma Edupage. Zhvillohen në mënyrë të organizuar për pedagogët dhe studentët orë seminaresh dhe trajnimesh, manuali i përdorimit për pedagogët dhe studentët. Edupage është platforma elektronike e informimit të studentëve. Me kalimin e mësimit online, u shfaq një nevojë e madhe e përdorimit të teknologjisë dhe programeve kompjuterike për të bërë të mundur realizimin e procesit të mësimdhënies, për të garantuar vazhdimin normal të programeve mësimore Bachelor, për të mos krijuar një handicap të madh me pezullimin e procesit të mësimit për studentët me afate të papërcaktuara. Përdorimi i platformës Edupage vijon, dhe për Fakultetin Ekonomik u shtua dhe zhvillimi i mësimit në platformën Google aplikacionin Google classroom. Më tej për të plotësuar mangësitë e hasura e për një paraqitje më të mirë e më të plotë, KU Logos vendosi në përdorim të pedagogëve dhe studentëve platformen e Microsoft office, Teams. Të dyja platformat Edupage dhe Teams, përdoren nga studentët për informim të të gjithë elementëve të procesit mësimor, si: frekuentimi i lëndës, leksionet në poëerpoint dhe/ose literature online, syllabusi i lëndës, detyrat, dorëzimi i detyrave, zhvillimi i testeve, rezultatet e secilit element të vleresimit të vazhduar dhe vlerësimi përfundimtar me notë i lëndës. Kjo ka qene totalisht në shërbim të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe gje qe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Kolegji Universitar “Logos” garanton akses të barabartë e pa pagesë në Katalogun elektronik të bibliotekës LOGOS: www.orthodoxalbania.org. Institucioni ka krijuar kushtet për akses në bibliotekat online JSTOR dhe EBSCO</p> <p>Studentët kanë akses në Revistën MONITOR Shqip - e cila përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Revista Monitor, formati dixhital, çdo javë, 50 botime (shfletim dixhital dhe në formë postimesh) - Akses në arkivën Monitor (monitor.al)
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Zhvillohen dhe shume trajnime me studentët sipas viteve akademike, për përdorimin e platformave. Kjo rezultoi në përdorimin e këtyre burimeve në realizimin e detyrave të kursit apo pjesëmarrjen në aktivitetet e studentëve të Fakultetit Ekonomik.</p> <p>Ndersa vihet re nje komunikim zyrtar i stafit me njeri tjetrin apo ashtu edhe me administraten apo studentet. Keshtu, personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemin e komunikimit të brendshëm nëpërmjet platformës Microsoft Office 365, ku secili nga anëtarët e stafit dhe studentët kanë adresën e tyre, përkatësisht për stafin akademik është emër.mbiemër@kulogos.edu.al, dhe për studentët është emër.mbiemër@s.kulogos.edu.al. Komunikimi bazohet në Urdhërin e përbashkët të autoriteteve drejtuese të Kolegjit Universitar</p>

	<p>Logos nr.2, datë 27.01.2021 për zhvillimin e aktivitetit akademik me studentët nëpërmjet platformës microsoft teams</p> <p><i>Shtojca nr.45.6: Llogaria në Bibliotekën Online</i></p> <p><i>Shtojca nr.45.5: Trajnime për bibliotekën</i></p> <p><i>Shtojca 59.5: Konferenca studentore "Ekonomia dhe dimensionit social"</i></p> <p><i>Shtojca nr.71.1.2: Përdorimi i MS Teams</i></p> <p><i>Shtojca nr.71.2: Shembull komunikimet me studentët</i></p> <p><i>Shtojca nr.66.6: Urdhër nr.2, datë 27.01.2021</i></p>								
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Përzgjedhje dhe realizimi i temës së diplomës është një proces i rëndësishëm. Mjaft koncepte të rëndësishme të teorisë dhe tematikave të vecanta që kanë marrë studentët në module të vecanta reflektohen pikërisht në realizimin e temës së diplomës. Një mësimdhënie e mirë reflekton një temë të mirë dhe cilësore të diplomës, një temë diplomë nuk përbën thjesht një punim final të studentit por një reflektim të kujdesshëm të koncepteve bazë që ka përfutur studenti gjatë të gjithë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kështu, për mbarëvajtjen e këtij procesi, personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave pasi ato janë propozuar dhe miratuar në takimet e departamentit dhe studentët janë njoftuar zyrtarisht. Pasi ata shprehin interesin e tyre për fushën dhe pedagogun përkatës, në takimin e rradhës së departamentit, përcaktohet lidhja e pedagogëve me studentët përkatës, bazuar edhe në kriterin e notës mesatare të nevojshme për kryerjen e punimit të diplomës.</p> <p><i>Shtojca nr.5, neni 107-115, Rregulloren e Departamentit të Menaxhimit Shtojca nr.6, neni 42-43 dhe nenet 45-48</i></p> <p><i>Rregulloren e Programit të Studimit Shtojca nr.7, neni 32</i></p> <p><i>Shtojca nr.68: Ndjekja e studentëve për diplomim</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi III.4</p> <p>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>KU Logos organizon të gjitha strukturat e duhura të cilat jo vetëm kontrollojnë cilësinë në mënyrë të vazhdueshme, por përdorin rezultatet e kontrollit për të promovuar në mënyrë të vazhdueshme përmirësimet e mundshme. Këto struktura përfshijnë: Komisionin e përhershëm të Garantimit të Cilësisë (KPGSC), Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) Komisionin e përhershëm për marrëdhëniet me studentët dhe Këshillin e Etikës. Bazuar në rregulloren e KU logos neni 16 pika 1, NJSBC raporton tek rektori I institucionit dhe më tej informacioni transmetohet në nivelin e njërive kryesore dhe bazë. Një nga tre qëllimet kryesore i shprehur dhe në misionin e KPGSC është edhe përmirësimi I cilësisë, përveç kontrollit</p>

	<p>dhe llogaridhënies. Të gjitha këto elemente shprehen gjithashtu edhe tek dokumentacioni i ofruar nga KU Logos që lidhet me procesverbalet e mbledhjeve të njësive, raportimet e ndryshme të NJSBC dhe procedurat e administrimit dhe vlerësimit të cilësisë.</p> <p><i>Shtojca nr.37.1 përbëjra e KPGSC</i> <i>Shtojca nr. 37.2 Përbërja e NJSBC</i> <i>Shtojca nr. 37.3 raporti vjetor I KPGSC</i> <i>Shtojca nr. 37.4.1 - 37.4.7 raportet vjetore të NJSBC</i> <i>Shtojca nr. 37.6 Procedura e administrimit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së mësimdhënies</i> <i>Shtojca nr. 37.7 Procedurat e vlerësimit të pyetësorëve të studentëve</i> <i>Shtojca nr. 37.8 Procesverbalet dhe agjendat e mbledhjeve të KPGSC 2020-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Bazuar mbi rregulloren e KU Logos si edhe në rregulloren e departamentit të Menaxhimit, ku ofrohet edhe kjo diplomë, Departamenti i Menaxhimit në KU Logos, si ofruesi dhe mbështetësi kryesor i programit të studimit, në bashkëpunim me Fakultetin, kanë në fokus të vazhdueshëm procesin e mësimdhënies si dhe cilësinë e tij. Në këtë kuadër, të dy këto njësi marrin pjesë aktive në organizimin e trainimeve të stafit nga KPPGSC dhe NJSBC si dhe organizojnë në mënyrë periodike, takime dhe tutorat për organizimin e aktiviteteve shkencore dhe sociale të cilat ndikojnë teks pedagogët dhe studentët, në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Fakti që ky departament përbëhet nga një numër i vogël staf akademik, përbën një avantazh sepse rrit fleksibilitetin dhe bashkëpunimin midis tyre. Edhe nga takimet në institucion, me stafin e këtij departamenti u vu re qartë komunikimi dhe integrimi i stafit me njeri tjetrin dhe përkushtimi i tyre drejt përmirësimit dhe rritjes cilësore. Në këtë kuadër, në përputhje me përcaktimet ligjore, veprimtaritë kërkimore bëhen mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuar, sipas procedurave të përcaktuara në Statutin e KU Logos.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 6 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojca nr. 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca nr 37.10 Trajnime për stafin akademik të organizaura nga KPGSC</i> <i>Shtojca nr, 36.2 Procesverbal kujdestarie Tutorat</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Në KU Logos, sipas evidencave të vëna në dispozicion ka disa burime se si strukturat mbështesin stafin mësimdhënës për zhvillimin e metodave të reja innovative. Kështu institucioni ka realizuar trajnime për stafin akademik si për përdorimin e platformave online si një teknologji innovative ashtu edhe për demonstrimin e metodave të reja në mësimdhënie në klasë. Institucioni realizon gjithashtu leksione të hapura dhe tryeza të rumbullakëta apo shume aktivitete te tjera si workshope të cilat evidentojnë metoda innovative që përfshijnë diskutimin, format e lojës, ftesa dhe angazhim të figurave të njohura jashtë institucionit në fushën e ekonomisë.</p>



<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Sikundër edhe në kriterin 3 të këtij seksioni përveçse ofruar nga vetë institucioni dhe përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, edhe në mënyrë individuale stafi akademik departamentit të Menaxhimit dhe stafit të programit të studimit ndjek kualifikime të vazhdueshme në fushat përkatëse të kërkimit shkencor duke kontribuar kështu në përmirësimin e mësimdhënies. Këto kualifikime vihen re në CV-të e stafit të departamentit dhe stafit të programit të studimit, si edhe në ngritjen profesionale të stafit me titujt përkatës. Institucioni ka dhënë gjithashtu mbështetje financiare për pjesëmarrjen në trajnime dhe zhvillim profesional të stafit.</p> <p><i>Shtojca nr. 34.1 Marrëveshje bashkëpunimi të ndryshme</i> <i>Shtojca nr. 37.10 Trajnime për stafin akademik të organizaura nga KPGSC</i> <i>Shtojca nr.79 Trajnime për stafin akademik organizuar nga KU Logos.</i> <i>Shtojca nr. 69.2 Trajnim I stafit akademik në Menaxhim projektesh</i> <i>69.4 Praktika të mbështetjes për promovimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme</i> <i>Shtojct nr. 59.1 Webinar</i> <i>Shtojca nr. 59.2 – Workshope</i> <i>Shtojca nr. 59.3 Tryeza të rrumbullakëta</i> <i>Shtojca nr. 59.4 Leksione të hapura dhe aktivitete të tjera</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni kujdeset për trajnimin e vazhdueshëm të stafit për përmirësimin e aftësive në mësimdhënie. Përvec trajnimeve për stafin akademik për përdorimin e platformave online, sic u përmend edhe më lart, stafi është trajnuar edhe metodat e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja. Këtu vlejnjë për tu përmendur edhe trajnimet në kuadër të marrëveshjeve Erasmus+ të cilat institucioni ka realizuar përmes zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe ka zbatuar sipas bashkëpunimit me departamentin, ku ka marrë pjesë pothuajse gjithë stafi i departamentit të menaxhimit.</p> <p><i>Shtojca nr. 34.1 Marrëveshje bashkëpunimi të ndryshme</i> <i>Shtojca nr. 37.10 Trajnime për stafin akademik të organizaura nga KPGSC</i> <i>Shtojca nr.79 Trajnime për stafin akademik organizuar nga KU Logos.</i> <i>Shtojca nr. 69.2 Trajnim I stafit akademik në Menaxhim projektesh</i> <i>Shtojca nr. 63.3 Mobiliteti I stafit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Zbatimi i programit të studimit është përgjegjësi e departamentit të Menaxhimit dhe stafit akademik jo vetëm të këtij departamenti por edhe stafit të departamenteve të tjera, por që japin mësim në këtë program studimi, kjo sipas rregullores së departamentit dhe rregullores së programit të studimit. Stafi angazhohet cdo fillim viti në përmirësimin e syllabuseve. Gjithashtu stafi i programit të studimit është angazhuar në përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja, duke përfshirë metoda si workshopet, diskutimet dhe rastet e studimit, metoda e lojës, etj</p>

	<p><i>Shtojca nr. 6 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojca nr. 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca nr. 64 procesverbal Departamenti I Menaxhimit Mirati mi I syllabuseve</i> <i>Shtojct nr. 59.1 Webinar</i> <i>Shtojca nr. 59.2 – Workshope</i> <i>Shtojca nr. 59.3 Tryeza të rrumbullakëta</i> <i>Shtojca nr. 59.4 Leksione të hapura dhe aktivitete të tjera</i></p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Mbetet përgjegjësi e personelit akademik të trajnuar që të transmetojnë tek studentët metodat dhe praktikat e reja të marra gjatë trajnimit sepse është pikërisht ky staf përgjegjës për realizimin e programit të studimit. Këto metoda të reja janë transmetuar tek studentët dhe këto njohuri kanë rezultuar të jenë me vlerë dhe metodat të jenë të suksesshme, edhe përmes raporteve të përvitshme. Nga ana tjetër, nxitja e këtyre bashkëpunimeve dhe partneriteteve ndikon, jo vetëm në rritjen cilësore të performancës së stafit, por edhe në ngritjen në një nivel më të lartë të transmetimit të dijeve tek studentët (metoda të reja mësimdhënie, mjete të reja mësimdhënie, metoda të reja të përfshirjes së studentëve në diskutim interaktiv). Kjo konfirmohet si në takimet me stafin e programit ashtu edhe në atë me studentët.</p> <p><i>Shtojca nr. 6 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojca nr. 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Takime me pedagogët e programit</i> <i>Takimi me studentët e programit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet mënyra e vlerësimit dhe testimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, të cilat pasqyrohen gjithashtu në syllabuset e lëndëve dhe zbatojnë VKM 41 në fuqi. Rregullorja e programit që paraqet dhe rregullat e testeve, është publike në faqen e internetit dhe njihet nga studentët. Në rastet e ndryshimit të kushteve të zakonshme është vendosur një rregullore e posaçme dhe dorëzimi i dosjeve elektronike të vlerësimeve për cdo lëndë.</p> <p><i>Shtojca nr. 7 Rregullore e programit të studimit nenet 24-27</i> <i>Shtojca nr. 19-1,2,3 Syllabuset e viteve akademike 19-20; 20 - 21; 21-22</i> <i>Shtojca nr. 66.3 Udhëzim 12 për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik 19-20.</i></p>

	<i>Shtojca nr. 66.5 Urdhër I përbashkët I autoriteteve akademike për provimet e sesionit të dimrit 20-21 online</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	<p>Studentët informohen mbi metodat e vlerësimit të njohurive dijeve e aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve që në orën e parë të zhvillimit të mësimin nga titullari i lëndës, i cili paraqet lëndën si edhe metodat e vlerësimit, të cilat janë të paraqitura qartë në syllabuset e lëndëve. Institucioni gjatë periudhës së zhvillimit të mësimin online zhvilloi disa testime për zhvillimin e provimeve online si dhe për orientimin me metodat e vlerësimit dhe mundësitë e sistemit online EDUPAGE dhe MS Teams.</p> <p><i>Shtojca nr. 19-1,2,3 Syllabuset e viteve akademike 19-20; 20 - 21; 21-22</i></p> <p><i>Shtojca nr 17.1.1 Përdorimi I EDUPAGE</i></p> <p><i>Shtojca nr. 17.1.2 Përdorimi I MS Teams</i></p> <p><i>Shtojca nr. 71.2 Shembull i komunikimit me studentët.</i></p> <p><i>Vizita në institucion:</i></p> <p><i>Takimi me pedagogët e programit</i></p> <p><i>Takimi me studentët e programit</i></p>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Sipas syllabuseve të lëndëve vihet re se ka një ndarje të vlerësimit duke u bazuar kryesisht në një vlerësim semestral prej 10%, vlerësim të mesit të semestrit prej 30% dhe vlerësim nëpërmjet provimit final prej 60%. Kjo tregon se ka një shpërndarje të vlerësimit në forma dhe mënyra të ndryshme, gjë që paraqitet edhe në rregulloren e programit të studimit (neni 24).</p> <p><i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 19-1,2,3 Syllabuset e viteve akademike 19-20; 20 - 21; 21-22</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Duke u bazuar në Rregulloren e KU Logos, rregulloren e programit të studimit si dhe në syllabuset e lëndëve duket qartë se ka një praktikë të mirë tek të gjitha lëndët për të zhvilluar testime dhe vlerësime të njohurive gjatë gjithë vitit akademik, nëpërmjet vlerësimit në seminare, detyra e projekte të ndjekura gjatë vitit si edhe dy testime kryesore, në mes të semestrit dhe në sezonin e provimeve.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i></p> <p><i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 19-1,2,3 Syllabuset e viteve akademike 19-20; 20 - 21; 21-22</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma	Gjatë periudhës së mësimdhënies online, Institucioni vuri në zbatim përmes urdhërësave dhe vendimeve përkatëse jo vetëm metodat e mësimdhënies por edhe ato të vlerësimit dhe testimit elektronik

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 42

<p>të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>online. Sa i përket mësimdhënies në kushtet e mësimimit fizik, <i>nuk përdoren sisteme elektronike</i>, por sipas rregullores, ka një procedurë të qartë të sekretimit, takimit pedagog-student për dhënien e vlerësimit si dhe procedurë e qartë për ankimimin për rezultatin. Komunikimi dhe vijmësia e procesit realizohet edhe elektronikisht nëpërmjet platformave EDUPAGE dhe MS Teams.</p> <p><i>Shtojca nr. 66.3 Udhëzim 12 për vijimin dhe mbylljen e vitit akademik 19-20.</i></p> <p><i>Shtojca nr. 66.5 Urdhër I përbashkët I autoriteteve akademike për provimet e sesionit të dimrit 20-21 online</i></p> <p><i>Shtojca nr 17.1.1 Përdorimi I EDUPAGE</i></p> <p><i>Shtojca nr. 17.1.2 Përdorimi I MS Teams</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p> <p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Komisionet e provimeve janë pjesë e vlerësimit të njohurive, dijeve e aftësive sipas rregullores së KU Logos dhe Rregullores së programit të studimit. Procesi i provimeve dhe përcaktimi i komisioneve të provimeve është transparent për studentët, të cilëve ju shpjegohet dhe vihen në dijeni për gjithë procedurën. Gjithashtu sipas rregullores provimet kryhen me sekretim dhe monitorimi i provimeve bëhet gjithashtu sipas rregullores gjithë infrastruktura e departamentit dhe stafi janë në dispozicion të procesit të monitorimit të realizimit në mënyrën e duhur të procesit.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i></p> <p><i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 72 Vendimi për datat e provimeve viti akademik 21-22, semestri I dytë</i></p> <p><i>Shtojca nr. 87 Korrespondenca me studentët për programin e provimeve</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas rregullores institucionalizohet vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit dhe situatat e ndryshme të reagimit të studentit si dhe radhën e veprimeve të kryera. Gjithë stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente/ feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/ testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/ prezantimit të detyrave/ projekteve të kursit dhe u jep këshilla/ orientime atyre se si mund të përmirësojnë performancën në të ardhmen. Duke qenë se ky program po vlerësohet edhe për kohën e mësimimit online, gjatë kësaj periudhe, platformat elektronike shërbyen për transparencën në vlerësim si dhe për format e dhënies së feedbackut përmes detyrave dhe vlerësimeve të testeve online.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i></p> <p><i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Shtojca nr 17.1.1 Përdorimi I EDUPAGE</i></p> <p><i>Shtojca nr. 17.1.2 Përdorimi I MS Teams</i></p> <p><i>Vizita në institucion:</i></p> <p><i>Takimi me pedagogët e programit</i></p> <p><i>Takimi me studentët e programit</i></p>

<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Përgjegjësia për shmangien e praktikave të gabuara dhe kopjimit në provime u takon anëtarëve të komisionit të cilët monitorojnë procesin, sipas rregullores së KU Logos dhe rregullores së programit të studimit. Gjithashtu lektori përgjegjës i lëndës është përgjegjës për moslejimin e plagjiaturës në detyra, nëpërmjet formave të vendosura të kontrollit. <i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i></p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas rregulloreve përkatëse rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë. Sipas nenit 25 në rregulloren e programit të studimit, koha e dorëzimit të procesverbalit me vlerësimet është jo më tepër se 5 ditë pune nga realizimi i provimit. Sa i përket vlerësimit me meritë, procesi i sekretimit, monitorimit si edhe përcaktimi i qartë i përqindjeve të vlerësimit në rregulloren e programit të studimit, garanton pikërisht këtë aspekt të vlerësimit në programin e studimit ashtu si edhe në institucion në përgjithësi. Ankimimi ndaj procesit është e drejtë e studentit e garantuar nga neni 27 I rregullores së programit të studimit, i cili jep gjithashtu afatet dhe procedurën e ndjekur nga përgjegjësi i departamentit ndaj ankimimit dhe rishikimit e vlerësimit.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas këtij neni, Përgjegjësi ngre një komision AD hoc të vlerësimit kur e sheh të pamundur zgjidhjen e kërkesës për ankimim me dakortësi të studentit. Komisioni AD-hoc përbëhet nga tre anëtarë dhe bazohet mbi dokumentacionin përkatës, duke marrë vendim të formës së prerë brenda 3 ditëve pune.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas këtij neni, Përgjegjësi ngre një komision AD hoc të vlerësimit kur e sheh të pamundur zgjidhjen e kërkesës për ankimim me dakortësi të studentit. Komisioni AD-hoc përbëhet nga tre anëtarë dhe bazohet mbi dokumentacionin përkatës, duke marrë vendim të formës së prerë brenda 3 ditëve pune. <i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.7</p>	
<p>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi mësimor Bachelor në Menaxhim Turizmi është organizuar në mënyrë të tillë që të përmbushë disa njohuri të thelluara në dy vitet e para të studimit, që lidhen me aftësitë bazë profesionale të menaxhimit të një biznesi në përgjithësi. Megjithatë, duke qenë menaxhimi në një sektor, madje industri shumë specifike sic është industria e turizmit që është komplekse, si lidhur me punësimin ashtu edhe me menaxhimin, investimet dhe marketingun, studenti ka nevojë për marrjen e disa njohurive dhe aftësive për ta kuptuar thellësisht funksionimin e sektorit. <i>Kështu mungojnë disa lëndë bazë në sektorin e turizmit sic janë Baza të turizmit dhe turizmi i qëndrueshëm</i>, të cilat janë kryesore për të dhënë aftësitë bazë në sektorin e turizmit, për të kuptuar menaxhimin dhe ekonominë e këtij sektori të ndërthurur mes udhëtimit, qëndrimit, marketingut etj. Aftësitë profesionale dhe të veçanta të</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 44



	<p>studentëve janë planifikuar të ndërtohen kryesisht gjatë vitit të tretë të studimeve bachelor.</p> <p><i>Shtojca nr. 14 Planet mësimorë të programit të studimit sipas viteve</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të vecanta në fushën e teknologjisë së informacionit nëpërmjet lëndëve të kategorisë D si Bazat e informatikës dhe Baza të dhënash, si dhe të kategorisë C si sisteme të kompjuterizuara të rezervimit në sektorin e turizmit. Sa u përket aftësive në fushën humane e sociale komunikimi dhe ndërveprimit, disa lëndë të kësaj natyre përfshihen në program, sic janë Gjuha e huaj si lëndë e kategorisë D në vitin e parë, lëndët e lidhura me komunikimin si menaxhimin dhe marketingun, si lëndë të kategorisë B, gjatë viteve të para të studimit si edhe lënda sociologji turistike dhe Turizëm kultror si lëndë të kategorisë B dhe C, në vitin e tretë të studimeve.</p> <p><i>Shtojca nr. 14 Planet mësimorë të programit të studimit sipas viteve</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Shqyrtimi dhe analiza e aftësive të fituara të studentit realizohet në përfundim të lëndës sipas metodave të vlerësimit të përmendura në syllabus, për të cilat testohen fitimi i aftësive dhe kompetencave të vendosura në syllabus. Sa i përket vlerësimit se si këto aftësi dhe kompetenca testohen, kjo mund të kontrollohet përmes pyetesorëve të realizuar tek studentët e programit. Përgjatë lëndës, por edhe në përfundim të çdo semestri, lektori i lëndës orienton studentët për të kuptuar pikat më të rëndësishme të kursit dhe ato ku duhet të përqendrohen gjatë testimit, por sidomos gjatë aktiviteteve praktike në fushën përkatëse.</p> <p><i>Shtojca nr. 19-1,2,3 Syllabuset e viteve akademike 19-20; 20 - 21; 21-22; Vizita në institucion: Takimi me pedagogët e programit; Takimi me studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>KU Logos ofron mundësi që lektorët e programit të studimit të realizojnë orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë edhe jashtë strukturës së programit të studimit. Kështu janë zhvilluar workshope dhe leksione të hapura, ndër të cilat disa të rëndësishme janë ofruar specifikisht për fushën e turizmit dhe jo vetëm me lektorë të huaj, por edhe me sipërmarrës operatorë shumë të suksesshëm në industrinë e turizmit.</p> <p><i>Shtojct nr. 59.1 Webinar</i> <i>Shtojca nr. 59.2 – Workshope</i> <i>Shtojca nr. 59.3 Tryeza të rrumbullakëta</i> <i>Shtojca nr. 59.4 Leksione të hapura dhe aktivitete të tjera</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Mësimdhënia në këtë program studimi zhvillohet kryesisht në auditor dhe aspektet praktike realizohen përmes ilustrimeve me raste studimore, zgjidhjeve praktike të situatave të dhëna apo të krijuara në klasë. Detyrat e studentëve dhe projektet u japin po ashtu mundësinë e zhvillimit të njohurive në terren. <i>Nuk ka një laborator përkatës specifike për turizmin, por lëndët specifike të bazave të informatikës dhe bazat e të dhënave zhvillohen në laborator.</i> Gjithashtu zhvillohen në mënyrë</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia në këtë program studimi zhvillohet kryesisht në auditor dhe aspektet praktike realizohen përmes ilustrimeve me raste studimore, zgjidhjeve praktike të situatave të dhëna apo të krijuara në klasë. Detyrat e studentëve dhe projektet u japin po ashtu mundësinë e zhvillimit të njohurive në terren. <i>Nuk ka një laborator përkatës specifike për turizmin, por lëndët specifike të bazave të informatikës dhe bazat e të dhënave zhvillohen në laborator.</i> Gjithashtu zhvillohen në mënyrë</p>

	<p>rigoroze praktikat profesionale, që u japin studentëve mundësinë e zhvillimit të aftësive praktike pranë bizneseve në fushën e turizmit.</p> <p><i>Shtojca nr. 14 Planet mësimorë të programit të studimit sipas viteve</i></p> <p><i>Shtojcat nr. 67.1 Format për detyrën e Kursit</i></p> <p><i>Shtojcat nr. 67.2 Detyrë kursi shembull student</i></p> <p><i>Shtojcat nr. 67.3 Detyrë kursi në grup shembull...</i></p> <p><i>Shtojca nr. 73 Dosje e plotë e praktikës profesionale</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit mbështet diskutimet dhe punën në grup, si gjatë orëve të seminareve dhe diskutimeve në klasë në rastet e ndryshme studimore, ashtu edhe në zgjidhjen e problematikave përmes detyrave të kursit, ku ka raste që detyrat jepen në grupe studentësh. Në këtë mënyrë stafi promovon punën e skuadrës tek studentët. Ilustrime janë edhe aktivitete e realizuara të lidhura me konferencën studentore apo webinarët në përbushje të temave të caktuara. Për të siguruar një vijimësi dhe siguri që përpjekjeve që stafi dhe përgjegjësi i departamentit bën për të integruar studentët dhe rrisin cilësinë, me ate cka kanë interes studentet nga ana e tyre, i gjithë departamenti mundohet të përfshijë studentët në opinione e mendime si për mësimdhënien ashtu edhe në sugjerimet që ata mund të japin për studime të avancuara apo nevoja të ndryshme që mund të kenë bizneset në fushën e turizmit. Në këtë proces, personeli akademik mbështet idetë novative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit turistik dhe identifikon fushat dhe momentet që kanë nevojë për më tepër informacion dhe studim të mëtejshëm. Këto probleme pastaj bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në temat e diplomës. Këtu ndihmon pjesëmarrja e studentëve në mobilitete të programeve Erasmus, të cilët sjellin përvoja të programeve ndërkombëtare dhe nxisin mendimin inovativ dhe punën e mëtejshme të mundshme kërkimore.</p> <p><i>Shtojct nr. 59.1 Webinar</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p><i>Shtojca nr 63.1 Mobilitetete e studentëve</i></p> <p><i>Shtojca nr. 63.4 Informimi I studentëve për programet Erasmus</i></p> <p><i>Shtojcat nr. 67.3 Detyrë kursi në grup shembull...</i></p> <p><i>Vizita në institucion:</i></p> <p><i>Takimi me pedagogët e programit</i></p> <p><i>Takimi me studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p><i>Shtojca nr 63.1 Mobilitetete e studentëve</i></p> <p><i>Shtojca nr. 63.4 Informimi I studentëve për programet Erasmus</i></p> <p><i>Shtojca nr. 63.5 programi Erasmus për sipërmarrësit e rinj</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Ndërthurja e formave të mësimdhënies vjen edhe me institucionet bashkëpunuese sic janë universtetet e huaja, Si universteti Oradea, Rumani, për rritjen e mobiliteteve të studentëve. Konkretisht nga ky program studimi kanë marrë pjesë studente në programet e shkëmbimit të studentëve duke përfituar nga shkëmbimi në fushën Turizëm, udhëtim dhe kohë e lirë, në fakultetin e Turizmit gjeografisë planifikimit territorial dhe sportit.</p> <p><i>Shtojca nr 63.1 Mobilitetete e studentëve</i></p> <p><i>Shtojca nr. 63.4 Informimi I studentëve për programet Erasmus</i></p> <p><i>Shtojca nr. 63.5 programi Erasmus për sipërmarrësit e rinj</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Lidhur me provimin final dhe mbrojtjen e diplomës Departamenti i Menaxhimit bazohet mbi një procedurë të posaçme ku përfshihen disa hapa. Kështu departamenti u bën të njohur procedurën e cila bazohet tek rregulloret e institucionit, departamentit dhe programit të studimit (shtojcat 5, 6 dhe 7). Gjithashtu departamenti bën një listë të studentëve që planifikohen të mbrojnë diplomën bazuar në mundësitë e departamentit për udhëheqje dhe rezultatet e studentëve, pra notës së tyre mesatare. Atyre ju sygjerohet një grup temash të përcaktuara dhe më pas ata mund të zgjedhin temën dhe pedagogun udhëheqës. Mund të përfshihen në këto udhëheqje edhe specialist të kualifikuar nga institucione të tjera kërkimore. Kjo përbën edhe një mënyrë për të integruar stafin e brendshëm me eksperiencën e atij të jashtëm, ose për më shumë për të patur një mundësi që studentët të realizojnë një kërkim sado të vogël në biznese aktuale shqiptare në fushën e turizmit.</p> <p>Në rastin e studentëve që nuk përmbushin kriterin për të realizuar një temë diplome kërkimore, ata i nënshtrohen provimit final të diplomës, duke përfshirë këtu pyetjet nga të treja vitet në mënyrë të balancuar, të ndërtuara nga komisioni përkatës i diplomës në rang departamenti.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca nr. 74.1 Proces verbal miratimi I temave të diplomave departamenti I menaxhimit</i> <i>Shtojca nr. 74.2 Proces verbal miratimi I pyetjeve për provimin e diplomimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Ka një komunikim të mirë të pedagogëve dhe praktika të duhura për transmetimin e mbështetjes për kryerjen e provimit final se përgatitjen e temës studimore, sipas rastit. Ky komunikim ofron orientim dhe support për studentët.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca nr. 68 Ndjekja e studentëve për diplomim</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni mbështet studentët gjatë procesit të realizimit të temës së diplomës. Mbështetja nuk është vetëm e lidhur em komunikimin dhe orientimin, por edhe në lidhje me pjesë të ndryshme të proceseve të përpunimit të të dhënave, përpunimit të tyre, testimin si dhe shkrimin e temës.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 47

<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pedagogët kanë akses në programet e përpunimit të të dhënave dhe japin orientime përkatëse për këtë dhe gjithashtu KU Logos u ofron studentëve një model për shkrimin e temës, me orientimet përkatëse, të cilat ssqarohen edhe nga pedagogët udhëheqës.</p> <p><i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca nr. 10 Formati I punimit të temës së diplomës në bachelor</i></p>			
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> <p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas rregullores së KU Logos nenet 111 dhe 112 si dhe rregullores së programit të studimit, neni 32, në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë, për të cilën bëhet me dije menjëherë pas përfundimit të provimit, nga komisioni përkatës. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca nr. 15.1 Diploma bachelor menaxhim turizëm</i> <i>Shtojca nr. 15.2 Suplement Bachelor MT 2022</i></p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/ konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Rregullora e institucionit përcakton në nenet 114, 115 dhe 116 se student në përfundim të studimeve pajiset me kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, që do të thotë, me diplomën dhe suplementin, ashtu sikurse kërkohet nga standartet e vendosura nga MAS. Sipas rregullores së Arkivës, ajo mban një kopje të dokumentacionit të studentit për një afat të papërcaktuar, duke konfirmuar sipas rastit dhe kur kërkohen, këto informacione për diplomimin, vitin përkatës dhe informacion tjetër të lejuar me ligj.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca n.r 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca nr. 15.1 Diploma bachelor menaxhim turizëm</i> <i>Shtojca nr. 15.2 Suplement Bachelor MT 2022</i> <i>Shtojca nr. 62 Rregullore ARKivë-Protokolli</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>
--	------------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Dokumentacioni lidhur me personelin e institucionit, përfshirë personelin akademik dhe atë mbështetës menaxhohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe zyra e Arkivë-Protokollit. Zyra e Burimeve Njerëzore menaxhon dosjet personale të të gjithë punonjësve, dokumentacionin personal të cdo punonjësi, librezën e punës dhe ndryshimet në dosje për shkak të zhvillimit të karrierës dëshmitë e kualifikimeve të mëtejshme të stafit. Nga vizita në zyrën e burimeve njerëzore, u evidentuan mbajtja e të dhënave dhe dosjeve me të gjithë elementët, duke bërë një përzgjedhje me dy anëtarë të stafit dhe u pa saktësia e mbajtjes së informacionit për stafin. Zyra e Burimeve njerëzore gjithashtu ruan gjithë marrëveshjet kontraktuale të cilat përmbajnë organizimin e kohës së punës si për stafin PAE ashtu edhe për atë PAK. Institucioni ka hartuar gjithashtu edhe rregulloren për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale si pjesë e detyrimeve ndaj të dhënave të mbajtura për stafin akademik.</p> <p><i>Shtojca nr. 11 Politika të burimeve njerëzore</i> <i>Shtojca nr. 62. Rregullore e Arkivë-Protokollit</i> <i>Shtojca nr 76.1 Kontratë individuale e punës për personelin akademik të KU Logos</i> <i>SHtojca nr 76.2 Kontratë individuale e punës për personel me karakter akademik ndihmës administrative.</i> <i>Shtojca nr. 77 Rregullore për përpunimin ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>KU Logos ka hartuar statutin dhe rregulloret e institucionit të lidhura me burimet njerëzore, përkatësisht në nenet 23 dhe 43, 44 dhe 45, të cilat bazohen në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë, Kodin e Punës në RSH, statutin dhe rregulloren e institucionit. Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek gjithë procedurat për plotësimin e vendeve vakante në strukturë me rekrutimet. Procedura e verifikuar nga dokumentacionet mbështetëse dhe nga vizita në terren përfshin disa hapa të rëndësishme që nga përcaktimi i nevojës për personel bazuar mbi numrin e përgjithshëm të insitucionit, shpallja e një vendi vakant, hartimi i kriterëve e pranimit të përgjithshme dhe specifike, ngritja e komisionit ad-hoc, vlerësimi i dosjeve, zhvillimi i konkursit, informacioni përfundimtar dhe vendimi i emërimit. Procedurat, afatet e dorëzimit të dokumentacionit, procedura e konkurrimit, rezultatet, afatet e ankimimit janë objekt i zbatimit të statutit dhe rregullores lidhur me burimet njerëzore.</p> <p><i>Shtojca nr 2 Statuti I KU Logos</i> <i>Shtojca nr 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 11 Politika të burimeve njerëzore</i></p>

	<i>Shtojca nr 78 Paketë rekrutimi dhe përzgjedhjeje për personel akademik me kohë të plotë</i>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit janë pjesë e rregullores që i përket zyrës së burimeve njerëzore. Një element i rëndësishëm përgjatë procedurës është përcaktimi i kritereve të rekrutimit ku një rol të rëndësishëm luan komunikimi me departamentin dhe dekanatin përkatës. Çdo fillim viti KU Logos publikon vendet vakante dhe kriteret për punësimin. Ndërsa kriteret e përgjithshme përcaktohen në nivel Institucioni, kriteret e vecanta përcaktohen nga njësia bazë, sipas nevojave të saj për staf akademik. Në rastet kur ka kritere të veçanta ato lidhen kryesisht me kualifikimet e mëtejshme, eksperiencën brenda e jashtë vendit dhe sidomos të lidhur me pozicionin vakant, lëndët apo modulet e pambuluara dhe detyrat lidhur me programin specifik. Me zbatimin e procedurës së rekrutimit, janë krijuar edhe kushtet për përmbushjen e kritereve lidhur me stafin akademik të departamentit dhe programit të studimit. Në të gjithë procedurën e rekrutimit KU Logos zbaton Kodin e Punës, Ligjin e Arsimit të Lartë nr 80/2015 si dhe rregulloret e brendshme të institucionit.</p> <p><i>Shtojca nr 2 Statuti I KU Logos</i> <i>Shtojca nr 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 11 Politika të burimeve njerëzore</i> <i>Shtojca nr 76.1 Kontratë individuale e punës për personelin akademik të KU Logos</i> <i>Shtojca nr 76.2 Kontratë individuale e punës për personel me karakter akademik ndihmës administrative</i> <i>Vizita në institucion</i> <i>Takimi me zyrën e burimeve njerëzore</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Statuti i KU logos si edhe rregullorja garantojnë realizimin e detyrave të stafit akademik në këtë IAL, në mënyrë korrekte dhe të njëjtë për të gjithë. Procedurat e sipërpërmendura të punësimit, angazhimi në shpërndarjen e punës sipas kualifikimit dhe legjislacionit në fuqi për ndarjen e ngarkesave mësimore dhe punës administrative, si edhe krijimi i kushteve për zhvillim në karrierë dhe realizim të mësimdhënies në mjedise optimale, bëjnë që të përmbushet kriteri i punës së një stafi profesional dhe me të drejta të barabarta.</p> <p><i>Shtojca nr 2 Statuti i KU Logos</i> <i>Shtojca nr 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 11 Politika të burimeve njerëzore</i></p>

	<i>Shtojca 05 Tabela përmbledhëse RVB, shpërnarja e ngarkesës së stafit (tabelat 6 dhe 12).</i>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. Kjo paraqitet si nëpërmjet fakteve të trainimeve të stafit në CV-të përkatëse të tyre, po ashtu edhe në të dhëna të institucionit për ndjekje të trajnimeve të ndryshme të ofruara nga institucioni, nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të huaja në kuadër të programit Erasmus+, si edhe përmes trajnimeve të aplikuara nga vetë pedagogët dhe të mbështetura nga institucioni.</p> <p><i>Shtojca nr. 34.1 Marrëveshje bashkëpunimi të ndryshme</i> <i>Shtojca nr. 37.10 Trajnime për stafin akademik të organizaura nga KPGSC</i> <i>Shtojca nr.79 Trajnime për stafin akademik organizuar nga KU Logos.</i> <i>Shtojca nr. 69.2 Trajnim I stafit akademik në Menaxhim projektesh</i> <i>69.4 Praktika të mbështetjes për promovimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme</i> <i>Shtojca nr 63.3 Mobiliteti I stafit</i></p>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Kualifikimi i pedagogëve të Departamentit dhe të programit të studimit ka qenë ndër shqetësimet e drejtimit të institucionit, edhe në përmbushje të kriterëve të lëna nga akreditimi i mëparshëm. Kushtet që ky drejtim ka duke u nisur nga nivelet e larta, në nivel fakulteti dhe më pas në nivel departamenti lidhen kryesisht me krijimin e lehtësive të nevojshme për realizimin e zhvillimit profesional, lehtësi të lidhura me kohën në dispozicion, organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve, por edhe krijimin e mundësive për pjesëmarrje në konferenca, brenda e jashtë vendit, duke mbështetur pjesëmarrjet në aktivitete trajnuese, apo duke suportuar aplikimin në projekte ndërkombëtare me rëndësi në fushën e turizmit , pra për këtë porgram studimi. U jepet mundësia dhe informacioni stafit për realizimin e mobiliteteve me programin Erasmus+, por edhe me projekte apo programe të tjera të punës kërkimore shkencore. Si rrjedhim i kësaj mbështetjeje por sidomos edhe bazuar mbi kërkesën e vazhdueshme të vetë stafit për kualifikime, evidentohen disa raste të rritjes dhe zhvillimit të karrierës së pedagogëve.</p> <p><i>Shtojca nr.79 Trajnime për stafin akademik organizuar nga KU Logos.</i> <i>Shtojca nr. 69.2 Trajnim I stafit akademik në Menaxhim projektesh</i> <i>Shtojca nr 63.3 Mobiliteti I stafit</i></p>
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p>Angazhimi i stafit të departamentit dhe të programit të studimit është realizuar sipas legjislacionit në fuqi dhe paraqitet në tabelat shtojca të RVB. Departamenti përbëhet nga 5 anëtarë, duke përmbushur marrëveshjen specifike të institucionit me MAS nga të cilët 3 jane Dr. dhe 1 Msc dhe 1 Dr. proces. Shihet një zhvillim i burimeve njerëzore brenda departamentit pasi tabelat 1.1, 1.2 dhe 1.3 me stafin sipas viteve si dhe tabela 2.11, tregojnë që janë bërë përpjekje për angazhimin e stafit me tituj akademikë nga viti në vit, pasi ka një rritje të numrit të Dr dhe gjithashtu një personel qe ka qenë me gradë Msc është tashmë</p>

	<p>Dr. process. Lidhur me shpërndarjen e ngarkesave për përbushjen e objektivave të programit, ajo bëhet sipas legjislacioni të fuqi dhe tregohet në tabelën 4.2. Koha vjetore e punës planifikohet në çdo fillim viti akademik sipas ligjit dhe kontratës së nënshkruar me stafin.</p> <p>Angazhimi i duhur i stafit në përbushje të objektivave shprehet në rezultatet e anketimeve të studentëve për stafin dhe vlerësimet e pedagogëve të rinj nga departamenti.</p> <p><i>Shtojca 05 Tabelat përmbledhëse RVB, shpërndarja e ngarkesës së stafit .</i></p> <p><i>Shtojca nr 76.1 Kontratë individuale e punës për personelin akademik të KU Logos</i></p> <p><i>Shtojca nr. 40.1 Formular vlerësimi nga studentët për veprimtarinë e departamentit_Teams 20-21</i></p> <p><i>Shtojca nr. 40.2 Formular vlerësimi nga studentët për cilësinë e mësimdhënies_Teams 20-21</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Ambjentet e Fakultetit të Ekonomisë janë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve të fakultetit e si rrjedhim edhe të studentëve të degës së Menaxhim Turizmi. Ambjentet fizike vendosen në kampusin nr 1 të KU Logos, me 4 salla leksionesh 4 seminaresh dhe 2 laboratorë për zhvillimin e lëndëve aplikative si Informatikë, statistikë etj. Godina e kampusit ka një sipërfaqe prej 5931 m², me adresë Rruga “Dritan Hoxha”, Pallatet “Komfort” Tiranë. Mjediset janë ndërtuar bazuar mbi kushtet e nevojshme teknike dhe higjienosantare, si dhe i nënshtrohen kontrollit bazuar mbi një kontratë për sigurinë dhe mbrojtjen në punë. Institucioni zbaton edhe standartet e rëndësishme si ato për mbrojtjen nga zjarri, akustikën dhe zhurmat, kushtet e temperaturës etj. Studentët dhe pedagogët kanë akses në ambientet e bibliotekës , sallën për aktivitete promovuese, sallën e internetit, zyrën e studentëve, sallat e fotokopjes dhe mjedise të tjera të përbashkëta.</p> <p><i>Shtojca nr 05 Tabela përmbledhëse RVB, mjediset e fakultetet/njësive bazë (Tabela 16)</i></p> <p><i>Vizita në institucion, në ambientet e institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik</p>	<p>Çdo sallë e leksioneve është pajisur me videoprojektor dhe pedagogët dhe me pajisjet e nevojshme për realizimin e leksioneve dhe seminareve Për cdo leksion mundësohet pra prezantimi PPT. laboratorët janë të pajisur me një numër të mjaftueshëm kompjuterash dhe softwarët përkatës duke patur parasysh grupet e studentëve dhe numrin e tyre. Mjediset janë të përshtatshme për realizimin e orëve të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 52

<p>e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>leksionit dhe seminareve për programin e studimit. Biblioteka në kontekstin fizik është një aspekt i rëndësishëm për studentët dhe pedagogët, aty ka mjediset e domosdoshme për studim dhe kompjutera desktop në dispozicion për të aksesuar edhe bibliotekën dixhitale.</p> <p><i>Shtojca nr 05 Tabela përmbledhëse RVB, mjediset e fakultetet/njësive bazë (Tabela 16)</i></p> <p><i>Vizita në institucion, në ambjentet e institucionit.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p><i>Nuk ka laboratorë specifike për programin e studimit. Duke qenë edhe se numri i studentëve në degën e menaxhim Turizmi është i kufizuar, nuk ka një motivim për laboratorë të veçantë, por mund të sygjerohen aplikacione specifike për tu vendosur në laboratorin e informatikës dhe realizimin e disa orëve sa i përket teknologjisë së informacionit dhe sistemeve të rezervimit, në të ardhmen.</i></p> <p><i>Shtojca nr 05 Tabela përmbledhëse RVB, mjediset e fakultetet/njësive bazë (Tabela 16)</i></p> <p><i>Vizita në institucion, në ambjentet e institucionit.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka dy laboratorë informatike, nga të cilët një është përshtatur për fakultetin e ekonomisë dhe përmban përveç programeve bazë për aftësimin në teknologjinë e informacionit, edhe disa programe të veçanta për aftësimin në fushën e ekonomisë dhe biznesit, kryesisht programet financë-kontabilitet dhe një program përpunimi statistikor (Programi R – një open source software). Ky përmbush aftësimin bazë në fushën e ekonomisë dhe biznesit. <i>Megjithatë për të ardhmen do të sygjerohej një ndërlidhje me programe të veçanta që përdoren nga fusha e turizmit, sic u tha edhe në kriterin 3 më lart.</i></p> <p><i>Shtojca nr 05 Tabela përmbledhëse RVB, mjediset e fakultetet/njësive bazë (Tabela 16)</i></p> <p><i>Shtojca nr. 70 Gjuha e programimit R</i></p> <p><i>Vizita në institucion, në ambjentet e institucionit.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Sa i përket zhvillimit të praktikave mësimore ato zhvillohen në fund të programit të studimit dhe zhvillohen nga studentët në bashkëveprim me operatorët turistikë me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Mjediset e tyre janë të përshtatshme për realizimin e praktikave dhe monitorohen sipas procedurave të përcaktuara në rregullore mbi modulën e praktikave mësimore.</p> <p><i>Shtojca nr 05 Tabela përmbledhëse RVB, Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi studimi (Tabela 5)</i></p> <p><i>Shtojca nr. 34 Marrëveshje bashkëpunimi</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedisë mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedisë të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është pjesë përbërëse e mjediseve të KU Logos dhe si rrjedhim edhe në funksion të programit të studimit në këtë vlerësim. Studentët dhe pedagogët e programit kanë mundësi të barabarta për shfrytëzimin e të dy sallave, si ajo e leximit ashtu edhe ajo e kompjuterave në amjentet e bibliotekës. Nga vizita në institucion u vu re se biblioteka frekuentohej nga studentët dhe ka orare të përcaktuara, të përshtatshme, duke qenë e hapur për ta në mënyrë të barabartë. <i>Shtojca nr 05 Tabela përmbledhëse RVB, mjediset e fakultetet/njësi bazë (Tabela 16); Vizita në institucion, në ambjentet e institucionit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka përmban gjithë literaturën e nevojshme dhe të domosdoshme të lidhur me programet e studimit. Gjithë literaturat në formën e librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe të huaj janë të kategorizuara sipas standarteve të bibliotekave, ka punonjës të trainuar lidhur me organizimin dhe menaxhimin e bibliotekave. Numri i titujve është i konsiderueshëm sipas RVB dhe mbulon të gjitha fushat e studimit në degën e ekonomisë, biznesit dhe sidomos edhe në degën e turizmit, ku fokusohet edhe ky program studimi. Titujt në fushën e turizmit janë gjithëpërfshirës, si në literaturë në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhë të huaj. <i>Shtojca nr 05 Tabela përmbledhëse RVB, Të dhëna të plota për platformat online struktura e teknologjisë së informacionit, bibliotekat online (Tabela 17)</i> <i>Vizita në institucion, në ambjentet e institucionit dhe bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sot ka vlerë më shumë aksesit on-line në bibliotekat dixhitale dhe kjo garantohet nga Institucioni, i cili përmbush kriterin e aksesit të barabartë në bibliotekat online, EBSCO. JSTOR. Gjithashtu ka abonim pa limit në revistën Monitor. Ekziston edhe katalogu elektronik i bibliotekës Logos, i lidhur me faqen www.orthodoxalbania.org.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur gjithashtu me sallën e kompjuterave me programet përkatëse nga ku studentët mund të aksesojnë katalogun elektronik dhe gjithashtu mund të kërkojnë për literature dhe në sistemet online të bibliotekave të cilat adopton KU Logos, konkretisht sistemi PLEIADES që bazohet në standarfëtn MARC 21. <i>Shtojca nr 05 Tabela përmbledhëse RVB, Të dhëna të plota për platformat online struktura e teknologjisë së informacionit, bibliotekat online (Tabela 17)</i> <i>Vizita në institucion, në ambjentet e institucionit dhe bibliotekës.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Plani i bibliotekës për përditësimin e fondit është pjesë e punës për bibliotekën dhe synon shtimin e zërave aktualë me zëra të tjerë me vlerë edhe për programin e studimit. Gjithashtu KU Logos bashkëpunon me institucione të tjera të huaja për të bashkëpërdorur edhe fondet e tyre sidomos lidhur me bibliotekat online. Kështu ai ka një marrëveshje aktuale me universitetin e Pireaus dhe është në process për të realizuar dhe një marrëveshje të tillë me universitetin Aristoteli të SELANIKUT dhe Universitetin e Janinës. <i>Shtojca nr 45.2 Strategjia e Bibliotekës 2019-2023</i></p>

	<i>Vizita në institucion, takimi në ambjentet e institucionit dhe bibliotekës.</i>		
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Oraret e shërbimit të bibliotekës janë të përshtatshme për studentët dhe vendosen në rregulloren e bibliotekës. Ato janë nga ora 08:00 deri në 20:00, gjatë gjithë ditëve përveç pushimeve dhe festive zyrtare. <i>Shtojca nr 45.3 Rregullore e bibliotekës</i> <i>Vizita në institucion, takimi në ambjentet e institucionit dhe bibliotekës.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	KU Logos përdor sistemin elektronik Edupage për ruajtjen e të dhënave për studentët si të dhëna personale, prezencën në mësim, vlerësimet sipas formave të ndryshme të përdorura sipas lëndëve/moduleve. Ky sistem mund të aksesohet nga sekretaria mësimore për të marrë dhe përpunuar të dhëna si: Numri i studentëve për cdo vit akademik Numri i transferimeve dhe cregjistrimeve Ecuria akademike e studentit Numri i ECTS të marra për cdo vit akademik për student Sistemi Edupage ka lehtësuar komunikimin midis studentëve dhe stafit akademik si dhe organizimin e vitit akademik për oraret dhe sallat. Gjithashtu KU Logos ka në dispozicion përdorimin për stafin dhe studentët llogarinë e tij në platformën office 365, ku secili anëtar dhe student ka llogarinë personale dhe mund të përdorë programet e office 365 si edhe platformën Teams. <i>Shtojca nr 39.2, Platforma Edupage</i> <i>Shtojca nr 39.3 Manual Edupage për pedagogët</i> <i>Shtojca nr. 39.4 Manual Edupage për studentët</i> <i>Shtojca nr. 39.5 Office 365</i> <i>Shtojca nr. 39.6 Manual Office 365 për pedagogët</i> <i>Shtojca nr. 39.7 Manual Office 365 Studentët</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit të dokumentacionit garanton në mënyrën tradicionale administrimin e gjithë informacionit për personelin akademi, ndihmës akademik, administrative. Ndërkohë sistemi Edupage mban gjithashtu të dhëna për pedagogët, kurset e tyre të mësimdhënies dhe komunikimin dhe transmetimin e të dhënave dhe informacioneve, si midis tyre dhe studentëve, ashtu edhe midis pedagogëve dhe strukturave administrative dhe midis pedagogëve me njëri-tjetrin. Kopjet e të dhënave ruhen në skedarë xls në mënyrë të shpërndarë. Në administrimin e informacionit për personelin akademik,

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>një rol kyç ka edhe Zyra e Burimeve Njerëzore. Sistemi Edupage lejon që informacioni të kalojë në mënyrë të menjëhershme dhe të sigurtë nga studentët , tek stafi, tek autoritetet e institucionit dhe midis njëri-tjetrit, duke përfshirë:</p> <p>Komunikimi pedagog-student Regjistri elektronik për temat, prezencën, notat Plani mësimor dhe materialet Orari mësimor Kotrolli mësimor i notave dhe mungesave nga sekretaria Gjenerimi i raporteve të ndryshme dhe statistikave nga sekretaria <i>Shtojca nr 39.2, Platforma Edupage</i> <i>Shtojca nr 39.3 Manual Edupage për pedagogët</i> <i>Shtojca nr. 39.4 Manual Edupage për studentët</i> <i>Shtojca nr 39.8 Procedura fillestare të një sistemi sigurie-shpërndarje të dokumentacionit të institucionit në GDrive</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Format e komunikimit interaktiv realizohen përmes platformës MS Teams, pra sistemit Microsoft 365. Ai mundëson realizimin e komunikimit ndërmjet personelit dhe studentëve si në rastet mësimdhënies ashtu edhe shkëmbimit të informacionit duke përfshirë materialet e kursit, programin e lëndës, skedarë në word ppt, materiale video dhe linke, me synim realizimin e programit të lëndëve dhe arritjen e objektivave të formimit të programit të studimit. Studentët dhe pedagogët janë informuar dhe trajnuar për përdorimin e platformës dhe gjithashtu guida jep orientimin e duhur për përdorimin në vazhdimësi dhe përdoruesit e rinj. <i>Shtojca nr. 39.5 Office 365</i> <i>Shtojca nr. 39.6 Manual Office 365 për pedagogët</i> <i>Shtojca nr. 39.7 Manual Office 365 Studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Edupage sic u përmend edhe më lart është sistemi që garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik sic janë përmbushja e detyrimeve për realizimin e orëve të mësimit, për vlerësimin e studentëve sipas formave të ndryshme të vlerësimit dhe metodave përkatëse dhe detyrime të tjera. Ky informacion aksesohet shpejt dhe lehtësisht nga titullarët sapo ata kanë nevojë. Secili ka një akses të hapur sipas llogarive në systemin Edupage. Pro të dhënat individuale në sistem janë të vlefshme vetëm për administratorët e sistemit dhe personat që kanë autorizimin për të parë dhe/ose përdorur këto të dhëna. Edhe në MS Teams ka një monitorim të informacioneve të kursit, sipas rastit dhe kërkesës për akses. <i>Shtojca nr 39.2, Platforma Edupage</i> <i>Shtojca nr. 39.5 Office 365</i> <i>Shtojca 38.6 Shembull I monitorimit në MS Teams</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku</p>	<p>Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit të KU Logos, në të dy gjuhë ku të njëra prej tyre është gjuha shqipe dhe tjetra është gjuha angleze http://www.kulogos.edu.al/al/index.html http://www.kulogos.edu.al/en/index.html</p>

të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Ligji i arsimit të lartë 80/2015 krijon gjithë hapësirat ligjore për ndërtimin e mekanizmave të duhur për menaxhimin financiar të institucionit dhe pjesëve përbërëse të tij. Në bashkëveprim me ligjin e buxhetit, si edhe me udhëzimet përkatëse, por edhe me komponentin administrative, tashmë të ndarë nga ai kërkimor shkencor, në universitete, është e mundur të kalohet deri në nivelin e programeve të studimit. Institucioni harton buxhetin e institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe shpërndan burimet financiare sipas shërbimeve që ofron duke iu referuar edhe programit të studimit të marrë në shqyrtim. Bazuar mbi të dhënat e buxhetit institucional mund të identifikohen disa kosto të programit të studimit. Buxheti gjithashtu përmban edhe nivelin e të ardhurave, ku arkëtohen të ardhura të mjaftueshme nga studentët, por edhe mbështetje nga fondacioni Logos i cili është në support financiar të KU Logos.</p> <p><i>Shtojca nr. 49.1 Vendim i SA për miratimin paraprak të projekt buxhetit 19-20</i></p> <p><i>Shtojca nr. 49.2 Vendim i bordit për miratimin e projekt buxhetit 2019</i></p> <p><i>Shtojca 49.3 Sygjerimet e njesive bazë për përpilimin e projekt buxhetit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 49.4 Udhëzues për hartimin e buxhetit</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit përmban të gjitha kostoto si për burimet njerëzore, ashtu edhe për shpenzimet operative mirëmbajtjen e mjediseve, teknologjive mbështetëse, bibliotekën, detyrimet financiare etj. Financimi planifikohet në fakt duke filluar me kërkesat nga departamenti për programet e studimit që ofrohen dhe për të gjitha kostoto dhe nevojat e tyre, nevojat për literaturë dhe shpenzime për bibliotekën, nevoja për shpenzime operative etj.</p> <p><i>Shtojca nr. 49.11 realizimi I buxhetit 2018-2019-2020 personeli</i></p> <p><i>Shtojca nr. 49.12 realizimi I buxhetit 2018-2019-2020 studentë</i></p> <p><i>Shtojca nr. 49.13 Kërkesa nga departamenti për bazë materiale</i></p> <p><i>Shtojca nr. 49.14 Rregullore e zyrës së financës</i></p> <p><i>Shtojca nr. 50 Të dhëna nga plani i financimit</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Raporti i auditimit i referohet legjislacionit në fuqi për KU Logos dhe vlerëson e dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të institucionit. Raporti përmban pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributin financiar nga mbështetja e fondacionit. Gjitashhtu zyra e financës është në kontroll dhe monitorim të vazhdueshëm të zbatueshmërisë së planit financiar, duke përmbushur detyrimet ligjore në fuqi si dhe duke dorëzuar bilancet në afatet kohore sipas përfundimit, në mbyllje dhe të ciklit të studimit</p> <p><i>Shtojca nr. 49.5 Raport auditimi</i> <i>Shtojca nr. 49.11 realizimi I buxhetit 2018-2019-2020 personeli</i> <i>Shtojca nr. 49.12 realizimi I buxhetit 2018-2019-2020 studentë</i> <i>Shtojca nr. 49.6 Njoftimi I detyrimeve</i> <i>Shtojca nr. 49.7 Detyrimet tatimore 2021</i> <i>Shtojca nr. 49.8 Akt konstatim DRT</i> <i>Shtojca nr. 49.14 Rregullore e zyrës së financës</i> <i>Shtojca nr. 49.9 Njoftim I dorëzimit të bilancit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>KU Logos ka pasqyruar sipas dokumentacionit të dorëzuar një stabilitet financiar falë edhe pjesëmarrjes në fondacionin “Logos” dhe mbështetjes së Kishës Ortodokse Autoqefale, në mbështetje të funksionimit normal jo vtëm të programeve të studimit por edhe punës kërkimore shkencore të institucionit.</p> <p>Burimet e të ardhurave listohen si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Financimi I Fondacionit “Logos” 2. Tarifat e studimit 3. Financime dhe donacione të tjera <p><i>Shtojca nr. 49.5 Raport auditimi</i> <i>Shtojca nr. 49.11 realizimi I buxhetit 2018-2019-2020 personeli</i> <i>Shtojca nr. 49.12 realizimi I buxhetit 2018-2019-2020 studentë</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>
---	--------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	--

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Pranimi i studentëve në KU Logos ashtu sikurse edhe ecuria përgjatë gjithë ciklit të studimeve bëhet duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, aktet rregullatore, agjencitë përkatëse QSHA dhe RASH si dhe kriteret e pranimit dhe kuotat e propozuara dhe të miratuara që publikohen edhe në faqen e Internetit. Institucioni ka objektiva të qarta lidhur me pranimin e studentëve dhe statute shprehet lidhur me autoritetet dhe zyrat përgjegjëse, si për përcaktimin e kriterëve ashtu edhe për koordinimin e procedurave të pranimit. Kështu, përcaktohet se Zyra e Çështjeve Studentore është përgjegjëse për procedurat e pranimit ndërsa senati akademik vendos për kriteret e pranimit duke komunikuar vendimet në gjithë strukturën e universitetit si dhe përmes mjeteve të ndryshme promovuese. Për më tej për vijimësinë e ciklit të plotë akademik të studentëve brenda institucionit e deri në dalje shprehet edhe rregullorja e programit të studimit.</p> <p><i>Shtojca nr. 7 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 47 Kriteret e pranimit të studentëve për programet e studimit që KU Logos ofron nga Web-i</i></p> <p><i>Shtojca nr. 51 Politika e marketingut të programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi</i></p> <p><i>Shtojca nr. 2 Statuti I KU Logos</i></p> <p><i>Shtojca nr 80.1 Vendim senati nr 9 për Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve</i></p> <p><i>Shtojca nr, 80.1.1 Renditja e studentëve raundi I parë dhe I dytë 2019-2020, 2020-2021</i></p> <p><i>Shtojca nr, 80.1.2 Vendim Senati nr 9 për Kuotat e studimit parashikuar nga KU Logos nga 2017-2020, për studentët e kategorive sociale të veçanta</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Parimet e transparencës dhe barazinë në trajtimin e studentëve jepen në statutin dhe rregulloren e KU Logos. Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit dhe publikimi i tyre garantojnë transparencë dhe si mundësi të barabarta për kandidatët për student. Gjithashtu mirëinformimi përmes mjeteve promovuese si dhe web-sitit të KU Logos krijon mjedisin për mundësi të barabarta tek kandidatët për student dhe studentët. KU Logos ka parashikuar edhe situatat e pranimit të studentëve të tjerë nga trojet shqiptare si dhe student të huaj, duke mirëpritur bazuar në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Gjatë vazhdimësisë së studimeve deri në përfundim, strukturat e njësisë bazë, Departamenti i Menaxhimit, Zyra e Çështjeve Studentore dhe Qendra e Karrierës japin shërbimet dhe mbështetjen e tyre pa asnjë dallim dhe diskriminim për të gjithë studentët duke i trajtuar ata në kushte të barabarta. Ofrimi i</p>

	<p>informacionit dhe shërbimeve bëhet sipas nevojave të studentëve. Sidomos Sistemi Edupage krijon kushtet për transparencën e informacionit dhe mbështet procesin për garantim të të drejtave të njëjta.</p> <p><i>Shtojca nr. 2 Statuti I KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 5 Rregullore e KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 9.7 Studentë të huaj në programin e studimit</i> <i>Shtojca nr. 9.8 Tabelë përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar në 2017-2020</i> <i>Shtojca nr 81.1 Leksione të hapura KU Logos 2018-2022</i> <i>Shtojca nr 81.2 Mjetet e komunikimit me studentët</i> <i>Shtojca nr 81.3 Materialet dhe broshura informuese për studentët</i> <i>Shtojca nr 81.4 Pranimi I studentëve të rinj, aktivitet</i> <i>Shtojca nr 81.5 Open days</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve bëhen publike në faqen e Internetit por edhe në mjediset e Institucionit. Po ashtu janë publike edhe kriteret e transferimit të studentëve dhe njohja e studimeve të mëparshme apo të pjesshme, të cilat janë transparente edhe brenda institucionit përmes rregullores se KU Logos dhe rregullores së Departamentit. Rregulloret përkatëse paraqesin edhe kriteret lidhur me vlerësimin e dijeve dhe përmeshjen e tyre për diplomimin e studentëve, për të pasqyruar saktësisht edhe përparimin gjatë kursit të studimit. Rregullorja e KU Logos i kushton kreun 9 deri në kreun 13 gjithë procesit të studentëve brenda institucionit duke filluar që nga pranimi e deri në diplomim. Rregullorja është e vendosur në web-sitin e institucionit dhe ju bëhet me dije studentëve që në momentin e hyrjes. Gjithashtu rregullorja e Departamentit në nenet 17 deri në 29 paraqesin gjithë procesin që nga kriteret e pranimit e deri tek të gjitha të drejtat dhe detyrimet e studentit duke përfshirë edhe transferimin dhe njohjen e studimeve etj.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e përgjithshme e KU Logos</i> <i>Shtojca nr 6 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojca nr 7 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Menaxhim Turizmi</i> <i>Shtojca nr 81.1 Leksione të hapura KU Logos 2018-2022</i> <i>Shtojca nr 81.2 Mjetet e komunikimit me studentët</i> <i>Shtojca nr 81.3 Materialet dhe broshura informuese për studentët</i> <i>Shtojca nr 81.4 Pranimi i studentëve të rinj, aktivitet</i> <i>Shtojca nr 81.5 Open days</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>KU Logos si në rregulloren e përgjithshme të institucionit edhe në rregulloren e departamentit përcakton se ai do të vendosi kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për tu pranuar në ciklin e parë të studimeve. Në zbatim të rregulloreve senati ndërton kriteret e pranimit me vendim të caktuar dhe zbaton këto kriteret në përzgjedhjen përfundimtare, duke i bërë ato publike.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e përgjithshme e KU Logos</i> <i>Shtojca nr 6 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i></p>

	<p><i>Shtojca nr. 47 Kriteret e pranimit të studentëve për programet e studimit që KU Logos ofron nga Web-i</i></p> <p><i>Shtojca nr 80.1 Vendim senati nr 9 për Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve</i></p> <p><i>Shtojca nr, 80.1.1 Renditja e studentëve raundi I parë dhe I dytë 2019-2020, 2020-2021</i></p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Si kriteret e përgjithshme ashtu edhe ato specifike, hartohen duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe pranimin e studentëve të huaj dhe/ose nga trojet Shqiptare ashtu sikurse parashikon legjislacioni dhe institucionet përgjegjëse.</p> <p><i>Shtojca nr. 47 Kriteret e pranimit të studentëve për programet e studimit që KU Logos ofron nga Web-i</i></p> <p><i>Shtojca nr 80.1 Vendim senati nr 9 për Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve</i></p> <p><i>Shtojca nr 80.2 Vendim rektorati për organizimin e fushatës së informimit 2020-2022</i></p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik KU Logos informon publikun dhe të gjithë të interesuarit në lidhje me kriteret. Publikimi i kriterëve bëhet në web-sitin e institucionit. Gjithashtu përdoren të gjitha mënyrat e informimit dhe promovimit të programit duke përfshirë edhe kriteret e pranimit si ato të përgjithshme ashtu edhe ato të veçanta për programin e studimit.</p> <p><i>Shtojca nr. 47 Kriteret e pranimit të studentëve për programet e studimit që KU Logos ofron nga Web-i</i></p> <p><i>Shtojca nr 81.2 Mjetet e komunikimit me studentët</i></p> <p><i>Shtojca nr 81.3 Materialet dhe broshura informuese për studentët</i></p> <p><i>Shtojca nr 81.4 Pranimi i studentëve të rinj, aktivitet</i></p> <p><i>Shtojca nr 81.5 Open days</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Rregullorja e përgjithshme e KU Logos dhe rregullorja e departamentit përcaktojnë të gjitha kriteret dhe procedurat për përparimin akademik të studentëve dhe kalimi nga një vit akademik në tjetrin. P.sh. në nenin 24, 25, 26 dhe 27 të rregullores së departamentit përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e studentit që ndër të tjera lidhen me të gjithë rrugëtimin e studentit dhe procedurat e përparimit akademik. Në nenin 32 paraqiten kriteret se si studenti kalon nga një vit në tjetrin.</p>

	<p>Këto informacione vihen në dispozicion për studentët si në seancat e informimit nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, ashtu edhe nëpërmjet broshurave informuese apo takimeve të tjera informuese. Gjatë këtyre takimeve studentët informohen lidhur me të gjitha mundësitë, të drejtat dhe detyrimet, paketat rregullative për studentët, platformat e mësimit online, mundësitë e përfaqësimit në organet drejtuese dhe këshillat studentore.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e përgjithshme e KU Logos</i> <i>Shtojca nr 6 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojca nr 82 Njihu me KU Logos</i> <i>Shtojca nr 83 Kalendarit akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e institucionit dhe të departamentit dhe të programit të studimit, paraqiten kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Studentët kanë të drejtën e transferimit të studimeve të tyre duke iu njohur studimet e mëparshme sipas kriterëve të vendosura nga institucioni, kjo falë sistemit të transferimit të krediteve ECTS dhe zbatimit të sistemit të Bolonjës. Institucioni ndërton komisionet për transferimin të cilat realizojnë procedurën e njohjes dhe krijohen me vendim dekanati, miratohen nga rektori sipas statutit dhe rregullores së departamentit. Gjithashtu në këtë proces mbështet rregullorja e transferimeve e cila paraqet jo vetëm dokumentat por edhe procedurën që do të ndiqet.</p> <p><i>Shtojca nr. 2 Statuti I KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 5 Rregullore e përgjithshme e KU Logos</i> <i>Shtojca nr 6 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojca nr. 85.1 Rregullore e transferimeve</i> <i>Shtojca nr. 85.2 Vendim dekanati për ngritjen e komisionit të transferimeve</i> <i>Shtojca nr 85.3 Praktikë e plotë mbi transferimin e studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve është pjesa më e rëndësishme në procesin e përparimit të studentit gjatë periudhës së studimeve, ndaj dhe ndërgjegjësimi i tij për metodat e vlerësimit, kriteret e vlerësimit të dijeve dhe informimi në mënyrë të vazhdueshme për gjendjen e studentit në procesin e vlerësimit të dijeve është pjesë e rregulloreve të KU Logos i cili paraqet në to të gjitha kushtet në të cilat studentët vendosen për të marrë vlerësimin e dijeve dhe aftësive të tyre në programin e studimit. Informacioni mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit gjendet në syllabuset e lëndëve të ndara nga pedagogët për cdo lëndë/ modul në sistemet elektronike për këtë qëllim si edhe informacioni për kriteret e vlerësimit të studentit që paraqiten në sistemet elektronike. Nga intervista me pedagogë dhe studentët vihet re se procesi është transparent dhe nuk shprehen probleme apo pakënaqësi lidhur me procesin. Në fakt paraqitet se ka dhe një komunikim në klasë që mbështet procesin dhe ndihmon në një mbarëvajtje sa më të mirë në procesin dhe transparencën e vlerësimit, ashtu sikurse në feedback-un e kërkuar nga pedagogët përmes sistemit të kontrollit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, mbi ecurinë e procesit të mësimdhënies. KU logos vendos edhe systemin e tutoratit i</p>

	<p>cili siguron ndjekjen e studentëve përmes tutorëve përgjatë programit të studimit për marrjen e këshillimit dhe mbështetjen përgjatë proceseve të vlerësimit apo ecurisë akademike të studentit.</p> <p><i>Shtojca nr. 14 Planet mësimore për vitet 19-20, 20-21, 21-22</i></p> <p><i>Shtojca nr. 19.1, 2, 3 - Syllabuset sipas viteve akademike</i></p> <p><i>Shtojca nr. 36.1 Për përcaktimin e koordinatorëve sipas programit të studimit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 36.2 Procesverbal përcaktimi i tutoratit për programin e studimit Menaxhim turizmi</i></p> <p><i>Shtojca nr. 36.3 rregullore Udhëheqje e kujdestari për studentët e KU Logos</i></p> <p><i>Shtojca nr. 68 Ndjekja e studentëve për diplomim</i></p> <p><i>Shtojca nr. 73 Dosje e plotë e praktikës së studentëve</i></p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e diplomimit janë subjekt i rregullores së departamentit dhe rregullores së programit të studimit, ku përcaktohen qartë numri i krediteve që duhet të ketë studenti për tu futur në procesin e diplomimit, si edhe kriteret që duhet të përmbushë për tu kualifikuar për temën e diplomës apo për provimin e diplomimit, gjithashtu edhe procedurat që duhet të ndjekë përgjatë procesit, që nga përzgjedhja dhe përcaktimi i udhëheqësit dhe temës së diplomës apo përcaktimi i bazës së pyetjeve të provimit të diplomimit. Këto procese ndiqen nga Departamenti i Menaxhimit i cili ka përgjegjësitë për vendimmarrjet përkatëse dhe garanton informimin e studentëve në afatet e duhura dhe të përcaktuara për informim.</p> <p><i>Shtojca nr. 6 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit</i></p> <p><i>Shtojca nr. 74.1 Procesverbal Departamenti Menaxhimi Miratim I temave të diplomave 21-22</i></p> <p><i>Shtojca nr. 68 Ndjekja e studentëve për diplomim</i></p>								
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Në KU Logos, përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, publikohen udhëzues të posaçëm dhe organizohen takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Kështu mund të përmenden takimet e Open day si edhe takime të tjera të realizuara për këto qëllime. Një nga praktikat e cila përmendet edhe nga vizita në institucion është marrëveshja e institucionit me shkollat e mesme për një promovim paraprak të degëve me interes për të rinjtë dhe shoqërinë shqiptare.</p> <p><i>Shtojca nr 34.2 Marrëveshje KU Logos me shkollat e mesme</i></p> <p><i>Shtojca nr 81.2 Mjetet e komunikimit me studentët</i></p> <p><i>Shtojca nr 81.3 Materialet dhe broshura informuese për studentët</i></p> <p><i>Shtojca nr 81.4 Pranimi i studentëve të rinj, aktivitet</i></p> <p><i>Shtojca nr 81.5 Open days</i></p> <p><i>Shtojca nr. 81.9 Angazhimi i stafit akademik për të prezantuar ofertën akademike të KU Logos</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="614 1780 826 1854"></th> <th data-bbox="826 1780 1029 1854">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1029 1780 1220 1854">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1220 1780 1428 1854">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="614 1854 826 1899"></td> <td data-bbox="826 1854 1029 1899"></td> <td data-bbox="1029 1854 1220 1899"></td> <td data-bbox="1220 1854 1428 1899">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimeve janë subjekt i rregulloreve të Departamentit të Menaxhimit dhe rregullores së programit të studimit Bachelor në Menaxhim turizmi. Informimi i studentëve mbi këto elemente bëhet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Botimit të rregulloreve në Web-sitein e KU Logos ● Prezantimit me rregulloret që në fillim të regjistrimit të studentëve në KU Logos dhe në takimet e para informuese ● Sekretarive dhe Zyrës së Cështjeve të Studentëve si edhe personelit mbështetës administrativ në departament ● Mjeteve informuese të vendosura në ambjentet e KU Logos dhe kampusit 1 <p>Gjithashtu në takimet e zhvilluara nga ana e institucionit, konkretisht Departamentit të Menaxhimit, informacionet janë të bollshme për të gjitha aspektet organizative dhe strukturore si edhe për kontributin e studentëve në strukturat organizative të institucionit.</p> <p><i>Shtojca nr. 2 Statuti I KU Logos</i> <i>Shtojca nr 36.2 Procesverbal kujdestarie Tutorati</i> <i>Shtojca nr 81.2 Mjetet e komunikimit me studentët</i> <i>Shtojca nr. 82 Njihu me KU Logos</i> <i>Shtojca nr 81.10 Aktivitete KU Logos për vitin akademik 20-22</i> <i>Shtojca nr.81.11 Aktivitete KU Logos për vitin akademik 17-20</i> <i>Shtojca nr. 84.1 Organizimi I zgjedhjeve të këshillit studentor</i> <i>Shtojca nr 84.3 Financimi I veprimtarive të propozuara nga Këshilli Studentor</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Mënyra se si institucioni informon studentët mbi programet e studimit dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese është përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Botimit të kurrikulës së detajuar me informacion për lëndët/modulet, kreditet, përmbajtjen dhe kategorizimin e veprimtarive në Web-site ● Komunikimi dhe vendosja në sistemet elektronike Edupage dhe MS Teams i të gjitha informacioneve në lidhje me lëndën duke përfshirë syllabusin ● Botime të Guidës së ku gjendet informacion idetajuar ● Prezantimit me informacionin që në fillim të regjistrimit të studentëve në KU Logos dhe në takimet e para informuese <p><i>Shtojca nr 36.2 Procesverbal kujdestarie Tutorati</i> <i>Shtojca nr. 66.5 Urdhër I përbashkët I autoriteteve drejtuese për provimet e sezonit të dimrit 20-21 online</i> <i>Shtojca nr 81.2 Mjetet e komunikimit me studentët</i> <i>Shtojca nr. 82 Njihu me KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 84.1 Organizimi I zgjedhjeve të këshillit studentor</i></p>

	<i>Shtojca nr 84.3 Financimi I veprimtarive të propozuara nga Këshilli Studentor</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Informacioni për studentët mbi mundësitë e punësimit si dhe mbështetja institucionale për orientimin drejt tregut të punës jepet nëpërmjet Zyrës së Çështjeve të Studentëve që dërgon përmes e-mailit këto informacione si edhe mundësi për këshillim për karrierën. KU Logos ka ndikuar në këtë drejtim edhe përmes rrjetit të Alumni të cilët kontribuojnë në orientimin e studentëve në tregun e punës, nëpërmjet informacionit, projekteve të ndryshme, bashkëpunime të mundshme. <i>Shtojca nr 81.10 Aktivitete KU Logos për vitin akademik 20-22</i> <i>Shtojca nr.81.11 Aktivitete KU Logos për vitin akademik 17-20</i> <i>Shtojca nr 34.3 Marrëveshjet e bashkëpunimit me bizneset</i> <i>Shtojca nr 81.2 Mjetet e komunikimit me studentët</i>			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, nëpërmjet web-sitet të KU Logos si edhe nëpërmjet komunikimit elektronik dhe sistemeve digjitale që përdoren nga institucioni. Komunikimet përmes adresës përfshijnë edhe ndryshime të lidhura me oraret apo organizime të ndryshme të procesit të mësimdhënies. Gjithashtu informacioni mbi infrastrukturën, bibliotekën, laboratorët ndodhet në faqen e internetit dhe transmetohet si nga stafi pedagogjik ashtu edhe nga ai mbështetës administrativ. <i>Shtojca nr 39.2, Platforma Edupage</i> <i>Shtojca nr 39.3 Manual Edupage për pedagogët</i> <i>Shtojca nr. 39.4 Manual Edupage për studentët</i> <i>Shtojca nr 81.2 Mjetet e komunikimit me studentët</i> <i>Shtojca nr. 82 Njihu me KU Logos</i>			
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Gjithë informacioni për programin e studimit, kryesisht duke u lidhur me lëndët e veçanta, kreditet, metodat e vlerësimit, oraret, semestrat vendoset në systemin elektronik Edupage dhe gjithashtu informacioni mbi materialet e mësimdhënies, testet, detyrat vendoset edhe në MS Teams, gjë që i bën lehtësisht të arritshme nga studentët patjetër edhe në distancë. <i>Shtojca nr 39.2, Platforma Edupage</i> <i>Shtojca nr 39.3 Manual Edupage për pedagogët</i> <i>Shtojca nr. 39.4 Manual Edupage për studentët</i> <i>Shtojca nr. 39.5 Office 365</i> <i>Shtojca nr. 39.6 Manual Office 365 për pedagogët</i> <i>Shtojca nr. 39.7 Manual Office 365 Studentët</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 65

pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Përmes Zyrës së Informacionit dhe Statistikës në bashkëpunim me Zyrën e Cështjeve Studentore grumbullon dhe përpunon të dhënat lidhur me regjistrimet/ aplikimet duke përpunuar të dhënat lidhur me moshën, shpërndarjen gjeografike, trajtimin me bursa, numrin e të diplomuarve. Të dhënat ruhen si në mënyrë elektronik ashtu edhe në kopje të shkruara në regjistrat e studentëve dhe janë në funksion të realizimit të gjithë shërbimit ndaj studentëve, informimit për MAS dhe agjencitë përkatëse. Numri i studentëve gjithsej në bachelor Menaxhim turizmi jepet edhe nga shtojca e tabelave të RVB, konkretisht tabela 21 cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve të programit Bachelor në Menaxhim Turizmi. Institucioni përmes zyrave të mësipërme gjithashtu mban informacion për të gjithë studentët që janë larguar nga programi përpara përfundimit, studentët që janë transferuar nga institucione të tjera apo për mospërfundimin me sukses të programit. Evidentimi për këto fakte bëhet në regjistrat pranë zyrës së Sekretarisë, duke marrë një kampionim për programin e studimit dhe për të parë standartet e ruajtjes së informacionit. Aktualisht programi ka 3 studentë të transferuar nga programe apo institucione të tjera. <i>Por numri i studentëve është shumë i ulët për këtë degë specifike.</i></p> <p><i>Shtojca nr. 05 Tabelat përmbledhëse të RVB, tabela 21, cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve të programit</i></p> <p><i>Shtojca nr 5. Rregullore e përgjithshme e KU Logos</i></p> <p><i>Shtojca nr. 9.2 Regjistër I studentëve</i></p> <p><i>Shtojca nr. 9.3 Regjistër elektronik I studentëve</i></p> <p><i>Shtojca nr. 9.4 Regjistër I diplomave</i></p> <p><i>Shtojca nr. 9.5.2 Regjistër I QSHA I diplomave</i></p> <p><i>Shtojca nr. 9.8 tabela përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2017-2020</i></p> <p><i>Shtojca nr. 62. Rregullore ARkivë-Protokolli</i></p> <p><i>Shtojca nr. 9.6.1 Regjstri I arritjeve (elektronik)</i></p> <p><i>Shtojca nr. 9.6.2 Regjstri I arritjeve (me shkrim)</i></p> <p><i>Shtojca nr. 9.7 Studentë të huaj në programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Të dhënat për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve nga pranimi deri në diplomim janë të lidhura me rezultatet për secilën lëndë, ato jepen përmes procesverbaleve të provimeve, duke vendosur notat në regjistra sipas lëndëve dhe semestrave. Në çdo moment student mund të tërheqë vërtetim për situatën e tij akademike për secilën lëndë, numrin e krediteve të fituara si edhe notën mesatare.</p> <p><i>Shtojca nr. 9.6.1 Regjstri I arritjeve (elektronik)</i></p> <p><i>Shtojca nr. 9.6.2 Regjstri I arritjeve (me shkrim)</i></p> <p><i>Shtojca nr 71.1. Platforma Edupage</i></p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes</p>	<p>Sistemi i brendshëm që përdoret për menaxhimin e të dhënave të studentëve është sistemi klasik i ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave.</p>

<p>sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Disa programe përpunimi si excel përdoren për përpunime në rastet e kërkuara, ndërsa sistemi Edupage përdoret për akses në informacionin mbi studentët për nxjerrjen e disa statistikave. Gjithsesi nuk ka një sistem të integruar informacioni, por pjesë të sistemeve digjitale përdoren në mënyra të ndryshme për të dhënat statistikore.</p> <p><i>Shtojca nr. 9.2 Regjistër I studentëve</i> <i>Shtojca nr. 9.3 Regjistër elektronik I studentëve</i> <i>Shtojca nr. 9.4 Regjistër I diplomave</i> <i>Shtojca nr. 9.5.2 Regjistër I QSHA I diplomave</i> <i>Shtojca nr. 9.8 tabela përmbledhëse me numrin e studentëve të regjistruar 2017-2020</i> <i>Shtojca nr 39.2, Platforma Edupage</i> <i>Shtojca nr 39.3,4 Manual Platforma Edupage për pedagogët dhe studentët</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>KU Logos harton raporte analitike si për cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve ashtu edhe për cilësinë e punësimit të tyre. Ai paraqet disa të dhëna nga tregu i punës nga ndjekja dhe gjurmimi i alumni.</p> <p><i>Shtojca nr. 17.1 Studim periodik i tregut të punës për programin bachelor në menaxhim turizmi</i> <i>Shtojca 17.2 Analiza e studimit të tregut 19-22</i> <i>Shtojca 17.3 Të dhëna për punësimin e studentëve</i> <i>Shtojca nr 38.1 dhe 2 Raportet vjetore të departamentit të menaxhimit 19-20 dhe 20-21</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi V.5


Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe këtyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në rregulloren e përgjithshme dhe rregulloren e departamentit të menaxhimit KU Logos parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve si përfaqësues në organet vendimmarrëse duke zbatuar rigorozisht aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për pjesëmarrjen dhe përfaqësueshmërinë e studentëve. Aplikimi është realizuar nëpërmjet përfaqësueshmërisë në Senat, Këshillin studentor, Këshillin e Etikës dhe NJSBC, ku kjo e fundit u evidentua edhe nga vizita në institucion.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore e përgjithshme e KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 84.1 Organizimi I zgjedhjeve të Këshillit studentor</i> <i>Shtojca nr 84.4. Statuti I këshillit studentor</i> <i>Shtojca nr. 84.5 Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>Shtojca nr. 86.1 Përbërja e Senatit Akademik</i> <i>Shtojca nr. 86.2 Përbërja e Këshillit të Etikës</i> <i>Shtojca nr. 86.3 Përbërja e NJSBC</i></p>

	<i>Shtojca nr. 87 Korrespondenca me studentët për programin e provimeve</i>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni garanton që përfshirja dhe përfaqësueshmëria e studentëve të jetë efektive, reale dhe konkrete. Rezultatet e këtij përfaqësimi janë :</p> <p>E drejta e studentëve për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur në mënyrë që të përfaqësohen në organet drejtuese dhe komisionet e përhershme garantohet nga statuti I KU Logos. Nga ana tjetër studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit të punës së programit dh pedagogëve përkatës, kjo përmes formularëve të anketimit të studentëve. Ky process u jep atyre një fuqi reale për të ndikuar në proceset e mëtejshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Studentët kanë rol në organizimin e panairit të karrierës, duke punuar vullnetarisht për këtë organizim. Gjithashtu ata kanë marrë pjesë edhe në promovimin tek shkollat e mesme. KU Logos siguron gjithashtu mbështetje për veprimtaritë e studentëve jashtë kurrikulës, që mund të jenë veprimtari muzikore, sportive, bamirësie etj. Departamenti i Menaxhimitka në rregulloren e tij pasqyron mbajtjen parasysh të ngarkesës akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> <p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 6 Rregullore e Departamentit të menaxhimit</i> <i>Shtojca nr. 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca nr. 84.1 Organizimi I zgjedhjeve të Këshillit studentor</i> <i>Shtojca nr. 84.3 Financim I veprimtarive të propozuara nga Këshilli studentor</i></p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p><i>Shtojca nr. 5 Rregullore KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 6 Rregullore e Departamentit të menaxhimit</i> <i>Shtojca nr. 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca nr. 84.1 Organizimi I zgjedhjeve të Këshillit studentor</i> <i>Shtojca nr. 84.3 Financim I veprimtarive të propozuara nga Këshilli studentor</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>KU Logos garanton që studentët të përfshihen në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve në mënyrë të rregullt në disa mënyra. Përveç përfaqësimit në organiet drejtuese, nga ku studentët marrin edhe informacon të rëndësishëm lidhur me këto procese, ata përfshihen edhe në proceset e vlerësimit të brendshëm gjë që u jep mundësi të reagojnë ndaj procesit duke qenë pjesë e ndryshimeve në përgjigje të vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu studentët përfshihen nëpërmjet NJSBC edhe nëproceset e vlerësimit, ku anëtari student ka rëndësi për procesin, pasi bën transparent dhe krijon një perceptim për rëndësinë e procesit tek kolegët e vet.</p> <p><i>Shtojca 92 Pyetësor I departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit</i></p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultati, rishikimit dhe reflektimit</p>	<p>Rregullorja e departamentit dhe e programit të studimit përmbajnë nenet përkatëse për tu dhënë mundësinë studentëve që të ankohen për rezultatet, të rishikojnë rezultatet dhe të marrin reflektimin nga ana e institucionit përmes përgjegjësit të departamentit, lektorit përkatës të lëndës apo edhe një komisioni të ngritur në raste të mospajtueshmërisë.</p>

nga ana e institucionit/ njësisë/ pedagogut përgjegjës.	Gjithashtu ata mund të shprehen në mënyrë anonime në pyetësorët e realizuar gjatë proceseve të kontrollit dhe monitorimit të cilësisë, mbi proceset e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve si edhe paanshmërinë e pedagogut në këto procese. <i>Shtojca nr. 6 Rregullore e Departamentit të menaxhimit</i> <i>Shtojca nr. 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Shtojca 92 Pyetësor i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit</i>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Tre nga pikat themelore brenda institucionit me përgjegjësi për informimin dhe shërbimin e studentëve janë sekretaria Mësimore, Departamenti i Menaxhimit dhe Koordinatori i Programit. Bazuar në rregulloren e institucionit, departamentit dhe programit të studimit, procedurat për informimin dhe shërbimet për studentët janë të qarta dhe përfshijnë këto organizma në institucion. Koordinatori luan një rol kyç për informimin e studentëve duke u fokusuar si tek të drejtat edhe tek detyrimet e tyre. <i>Shtojca nr. 5 Rregullore KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 6 Rregullore e Departamentit të menaxhimit</i> <i>Shtojca nr. 7 Rregullore e programit të studimit</i> Shtojca nr. 12 Rregullore mbi funksionimin e Zyrës së Çështjeve Studentëore dhe Këshillimit të Karrierës
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Gjithë çështjet organizative që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit paraqiten dhe janë transparente në faqen e Internetit të institucionit. Nga ana tjetër KU Logos përdor edhe sistemin digjital Edupage për informimin dhe monitorimin e ecurisë së studentit. Gjithashtu Në KU Logos procesi funksionon për të mbështetur studentin edhe në përfundim të studimeve dhe pas tyre, shpesh përmes këshillave dhe konsulencave, por edhe përmes ndonjë plani konkret bazuar mbi strukturat Alumni apo të Këshillimit të Karrierës. <i>Shtojca nr 71.1. Platforma Edupage</i> <i>Shtojca nr 81.10 Aktivitete KU Logos për vitin akademik 20-22</i> <i>Shtojca nr.81.11 Aktivitete KU Logos për vitin akademik 17-20</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret	KU Logos ka ndërtuar Zyrën e Çështjeve studentore dhe të Këshillimit të Karrierës, e cila u shërben studentëve, duke u ofruar për të mbështetur zhvillimin e karrierës së studentëve. Zyra vepron në bashkëveprim me stafin akademik të Departamentit të Menaxhimit



<p>studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>dhe ofron informacion mbi punësimin e mundshëm, praktikën, internship-in bazë të programeve përkatëse. Ajo ka mbështetur studentët në njohjen më të mirë të procesit të aplikimit për punë dhe dokumentacioneve të nevojshme. Zyra e Karrierës ka krijuar shumë mundësi për punësimin në tregun e përshtatshëm të punës, përmes promovimit, si dhe orineton studentët për kalimin në ciklin e dytë të studimeve për kompletimin e procesit mësimor, për praktikën profesionale e më tej.</p> <p><i>Shtojca nr. 81.8 orientim dhe këshillim I studentëve përkalim në ciklin e dytë</i></p>
--	--


<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të karrierës dhe Departamenti i Menaxhimit, për këtë program studimi qëndrojnë në kontakt të vazhdueshëm me punëdhënësit të sektorit dhe kompani të ndryshme të turizmit për të mundësuar kalimin e studentëve në tregun e punës. Komunikimi me punëdhënësit realizohet përmes një formulari ku zyra ndërton edhe të dhënat mbi Alumni dhe punësimin e studentëve. Në drejtim të mbështetjes për punësimin ndikojnë edhe aktivitete të tjera si ato të Zyrës Erasmus + dhe panairit e Punësimit që KU Logos organizon në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>Shtojca nr 17.3 Të dhëna për punësimin e studentëve</i> <i>Shtojca nr. 57 Formular I Vlerësimit nga Kompania për Ish-studentin Alumni</i> <i>Shtojca nr 34.3 Marrëveshje bashkëpunimi me Bizneset</i> <i>Shtojca nr 81.10 Aktivitete KU Logos për vitin akademik 20-22</i> <i>Shtojca nr.81.11 Aktivitete KU Logos për vitin akademik 17-20</i></p>
---	---

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një nga shtyllat ku KU Logos bazohet për realizimin e veprimtarisë së tij. Ai mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi, Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore përkatëse për të ngritur organizmat brenda institucionit për krijimin e standarteve dhe procedurave të cilësisë dhe për kontrollin e cilësisë. Këto organizma dhe struktura bazohen në procedura të qarta dhe në politikat e përgjithshme të institucionit për cilësinë, të shprehura në Statutin e tij. Strukturat e ngritura pranë KU Logos për cilësinë janë Komisioni I Përherëshëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Për pasqyrimin e politikave të cilësisë, nga KPGSC është ndërtuar edhe dokumenti i Politikave për Sigurimin e Cilësisë në nivel institucional.</p> <p><i>Shtojca nr. 2 Statuti I KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 13 Politika për sigurimin e cilësisë</i> <i>Shtojca nr. 37.1 Vendimi I Senatit për përbërjen e KPGSC</i> <i>Shtojca nr. 37.2 Vendimi I Senatit për përbërjen e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Bazuar mbi planin strtegjik të KU Logos, mund të themi se institucioni zbaton një strategji për përmirësimin e avazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen të gjithë aktorët. Sigurimi i cilësisë është në prioritetin strategjik 6 në pikën 2 dhe si rrjedhim KU Logos ka ngritur edhe të gjithë strukturën për të garantuar systemin e brendshëm të cilësisë. Pjesë e këtij sistemi janë jo vetëm strukturat, por edhe dokumentacioni dhe manualët përkatëse, përmes të cilit monitorohet procesi i mësimdhënies dhe bashkërendohet veprimtaria në të gjitha njësitë e institucionit që të arrihet një nivel i lartë i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. KU Logos ka në përbërjen e të dy strukturave nga një student për të garantuar përfshirjen e studentëve dhe gjithashtu merr masa për forcimin e kapaciteteve të strukturave përmes bashkëpunimit me ekspertë të jashtëm.</p> <p><i>Shtojca nr. 3 Plani strategjik I KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 37.1 Vendimi I Senatit për përbërjen e KPGSC</i> <i>Shtojca nr. 37.2 Vendimi I Senatit për përbërjen e NJSBC Shtojca nr. 37.8 dhe 37.9 Procesverbalet e KPGSC dhe NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe</p>	<p>KU Logos ka përdorur instrumentat e duhura për sigurimin e cilësisë, që përfshijnë si instrumentet e brendshme edhe ato të jashtme. Sikurse u përmendën më lart, njësitë e lidhura me garantimin e cilësisë përdorin edhe instrumentet e duhura formularët, pyetësorët dhe përpunimin e të dhënave prej tyre. Nga ana tjetër institucioni ka ndërmarrë procesin e akreditimit përmes të cilit ka realizuar edhe Vlerësimin e Brendshëm edhe Vlerësimin e Jashtëm duke i përdorur këto procese për të përmirësuar dhe promovuar cilësinë.</p>



proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	<p><i>Shtojcë nr. 37.4 Raporte NJSBC</i> <i>Shtojca nr 37.5 Paketa e instrumentave të NJSBC</i> <i>Shtojcë nr. 38.1 Raport I Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojcë nr. 38.2 Raport I Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojcë nr. 64 Procesverbal për miratimin e syllabuseve Departamenti I Menaxhimit</i> <i>Shtojcë nr.65.1 Raporti vjetor I KU Logos për vitin 19-20</i> <i>Shtojcë nr. 65.2 Raporti vjetor I KU Logos për vitin 20 – 21</i> <i>Shtojca nr 89 Raport I Fakultetit të Ekonomisë</i></p>			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	<p>Politika e institucionit për cilësinë është e qartë dhe garanton ndjekjen e procedurave periodike për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Ai paraqet në politikën e tij edhe përmbushjen e standarteve europjane për cilësinë ISO 9001: 2015. Ndiqet gjithashtu rregullorja për sigurimin e cilësisë e cila është pjesë integrale e rregulloreve të institucionit. Dokumentat dhe paketa e instrumenteve të përdorura krijojnë vazhdimisht në institucion mudnësinë për të patur një kulturë për cilësinë dhe një kërkesë të vazhdueshme për të arritur atë.</p> <p><i>Shtojca nr. 3 Plani strategjik I KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 13 Politika për sigurimin e Cilësisë</i> <i>Shtojca nr. 8 Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë</i> <i>Shtojca nr 37.5 Paketa e instrumentave të NJSBC</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Njësia e posaçme që kryen vlerësimin shqyrtimin, mbikëqyrjen, monitorimin e programeve të studimit të ciklit të parë është NJSBC. Pas mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të bazuara në paketën e instrumentave komisioni KPSSC ndërton raportet në nivel institucional duke identifikuar edhe rastet positive për tu promovuar në departamentet e ndryshme dhe për të dhënë kështu mesazhet e orientimet për ndërtimin e programeve të studimit me standarte të cilësisë. Në kuadër të procesit të kontrollit dhe përmirësimit kryhen disa kontrole/ monitorime sic është ai i kuadrit ligjor, i treguesve të cilësisë së personelit, studentëve, kërkimit shkencor dhe infrastrukturës. <i>Shtojca nr. 8 Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë</i>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Mekanizmat dhe proceset formale të përdorura nga KU Logos për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit të ciklit të parë përcaktohen në rregullore dhe zbatohen në vijimësi. Ato përfshijnë Paketën e Instrumenteve të cilësisë si dhe format e ndryshme të raportimit dhe analizave për cilësinë të cilat analizohen dhe shqyrtohen në nivel Departamentit, programi dhe Fakulteti.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 72


	<p>NJSBC gjithashtu i bindet një procedure për administrimin e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>Shtojca 37.3 Raporti vjetor i KPSSC</i></p> <p><i>Shtojcë nr. 37.4. 1-7 Raporte NJSBC në aspektet e ndryshme</i></p> <p><i>Shtojca nr 37.5 Paketa e instrumentave të NJSBC</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>NJSBC përdor paketën e instrumenteve të cilësisë të cilat përfshijnë formularë dhe pyetësorë të ndryshëm për të vlerësuar ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit. Kështu NJSBC në fund të cdo semestri organizon vlerësimin nga studentët ku ndjek metodologji të përcaktuara për evitimin e elementeve subjektivë, si dhe në fund të cdo viti realizon vlerësimin e stafit akademik dhe departamentit.</p> <p><i>Shtojca nr 37.5 Paketa e instrumentave të NJSBC</i></p> <p><i>Shtojca 92 Pyetësor i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve periodike të bazuara në instrumentat dhe metodologjitë përkatëse, dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit, përmes raporteve në nivel institucional, raportimit të KPSSC si edhe kalimit të raporteve në nivelet e ndryshme të fakultetit dhe departamentit, ku edhe diskutohen problematikat apo rastet positive.</p> <p><i>Shtojcat nr 37.7, Procedura e shqyrtimit të pyetësorëve të studentëve nga KPSSC</i></p> <p><i>Shtojca nr 37. 8 dhe 9 Procesverbalet dhe agjendat e mbledhjeve KPSSC dhe NJSBC</i></p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet e vlerësimit në KU Logos përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. Raportet e NJSBC bëjnë gjithashtu krahasime të treguesve dhe rezultateve midis semestrave dhe krahasimi mbi baza vjetore, evduentoen gjithashtu sygjerime të ndryshme të studentëve etj.</p> <p><i>Shtojca 37.3 Raporti vjetor I KPSSC</i></p> <p><i>Shtojcë nr. 37.4. 1-7 Raporte NJSBC në aspektet e ndryshme</i></p> <p><i>Shtojcat nr 37.7, Procedura e shqyrtimit të pyetësorëve të studentëve nga KPSSC</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me</p>	<p>Sipas edhe rregullores së cilësisë vlerësimi i brendshëm i programit kryhet periodikisht, në cdo semestër sa i përket vlerësimit të studentëve dhe cdo vit akademik sa i përket vlerësimit të pedagogëve dhe departamentit. Ky informacion përfshihet në raportin e</p>

<p>këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>vetëvlerësimit në kuadër të këtij akreditimi dhe është i detajuar lidhur me të gjitha raportimet që bëhen në nivel institucional për këtë aspekt të vlerësimit të cilësisë. <i>Shtojcë nr. 37.4. 1-7 Raporte NJSBC në aspektet e ndryshme</i> <i>Shtojcat nr 37.7, Procedura e shqyrtimit të pyetësorëve të studentëve nga KPSSC</i> <i>Shtojcë nr. 38.1 Raport I Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojcë nr. 38.2 Raport I Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojcë nr.65.1 Raporti vjetor I KU Logos për vitin 19-20</i> <i>Shtojcë nr. 65.2 Raporti vjetor I KU Logos për vitin 20 – 21</i> <i>Shtojca nr 89 Raport I Fakultetit të Ekonomisë</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Kryerja e vlerësimit përdor metoda dhe instrumente të ndryshme të cilat janë në përshtatje me natyrën specifike të fushës akademike të ekonomisë në përgjithësi dhe të Turizmit në vecanti për këtë program studimi. Raportet vjetore japin informacion mbi pjesët specifike të marra nga instrumentat për programin e studimit dhe për departamentit. <i>Shtojcë nr. 38.1 Raport I Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojcë nr. 38.2 Raport I Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojca nr 89 Raport I Fakultetit të Ekonomisë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programi të studimit bachelor në Menaxhim Turizmi, përdoren disa metoda të drejtpërdrejta, duke konsistuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit si dhe vëzhgime në auditor gjatë realizimit të rasteve apo ushtrimeve. Vlerësimi kryesisht është realizuar përmes pyetësorëve të studentëve por edhe analizës mësimore në raportet vjetore që bëhet çdo fund viti akademik në nivel departamenti dhe fakulteti. Metodot e drejtpërdrejta të vlerësimit si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim i didaktikës, procesit të të mësuarit, zbatohen në mënyrë individuale dhe të dhënat mblidhen në nivel departamenti. Raportet japin statistika lidhur me rezultatet e studentëve në testime si dhe gjatë provimit të shtetit apo diplomimit. <i>Shtojca nr 3</i> <i>Shtojca nr 8</i> <i>Shtojca 92 Pyetësor i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në</p>	<p>Më tej përdoren gjithashtu edhe metodat jo të drejtpërdrejta si pyetësorët e studentëve për përmirësimin e kurrikulës së ofruar, pyetësorët e Alumni ose të studentëve pas përfundimit të studimeve, pyetësorë të personelit akademik ndihmësakademik a administrative. Gjithashtu KU Logos mban kontakt dhe komunikim me punëdhëns duke marrë edhe feedback nga ana e tyre mbi elemente të cilësisë së programit të studimit. <i>Shtojca nr 57.1 Formular Alumni</i> <i>Shtojca nr 57.2 Formular i vlerësimit nga kompania për Alumni</i></p>



realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	<i>Shtojca 92 Pyetësor i departamentit drejtuar studentëve për përmirësimin e programit</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit</p>	<p>Sikurse u përmend edhe në kriteret e mëparshme gjithë procesi i garantimit të cilësisë bazohet në marrjen e mendimit nga të gjithë aktorët si ata të brendshëm ashtu edhe ata të jashtëm. Përmes procedurave dhe zbatimit me korrektësi të rregulloreve përkatëse, sidomos rregullores së cilësisë, garantohet përfshirja efektive e këtyre aktorëve, ku bëjnë pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stafet e brendshme dhe departamenti • Studentët nëpërmjet formave të vlerësimit dhe përfshirjes në organe drejtuese • Bizneset dhe punëdhënësit potencialë, përmes pyetësorëve drejtuar atyre dhe përfshirjes së të dhënave nga analiza të tregut. <p>Secili prej anëtarëve dhe grupeve të interesit sipas rregulloreve dhe sidomos sipas procedurave të sipërpërmendura si edhe në kuadër të praktikave të mira të raportimit në lidhje me cilësinë , ka një rol të qartë e të mirëpërcaktuar si dhe detyra konkrete. Studentët dhe pedagogët kanë detyrë për të përmbushur kriteret e cilësisë si dhe për tu përgjigjur me vërtetësi në formularët e identifikimit dhe monitorimit të cilësisë, departamenti dhe organet e tjera drejtuese duhet të përmbushë detyrimin për përcjelljen e duhur të informacionit dhe transparencën, strukturat e ngritura për cilësinë duhet të mbledhin e përpunojnë informacionin përmes procedurave të zbatuara me integritet dhe rigorozitet duke zbatuar edhe të drejtat e stafit dhe studentëve, si edhe detyrimet për analizën dhe raportimin tek organet drejtuese, duke përcjellë edhe kulturën e cilësisë. Në politikat e institucionit dhe rregulloren për cilësinë garantohet pjesëmarrja e të gjithëve dhe një ekuilibrim midis rolit të secilit anëtar të stafit akademik, ndihmës akademik, student dhe individ dhe organ drejtues. Aktivizimi dhe përfshirja e aktorëve të brendshëm staf dhe studentët në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademi, shmang diskriminimin dhe pabarazine, pasi cdokush ka të drejtë të jetë pjesë e proceseve, si për dhënien e informacionit dhe feedback-urt,</p>

<p>akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>ashtu edhe për tu zgjedhur në organet drejtuese dhe strukturat për sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>Shtojca nr. 3 Plani strategjik I KU Logos</i> <i>Shtojca nr. 13 Politika për sigurimin e Cilësisë</i> <i>Shtojca nr. 8 Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë</i> <i>Shtojca nr 37.5 Paketa e instrumentave të NJSBC Shtojcë nr. 37.4. 1-7 Raporte NJSBC në aspektet e ndryshme</i> <i>Shtojcat nr 37.7, Procedura e shqyrtimit të pyetësorëve të studentëve nga KPSSC</i> <i>Shtojcë nr. 38.1 Raport I Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojcë nr. 38.2 Raport I Departamentit të Menaxhimit</i> <i>Shtojcë nr.65.1 Raporti vjetor I KU Logos për vitin 19-20</i> <i>Shtojcë nr. 65.2 Raporti vjetor I KU Logos për vitin 20 – 21</i> <i>Shtojca nr 89 Raport I Fakultetit të Ekonomisë</i></p>								
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjatë proceseve të vlerësimit të cilësisë përfshirja e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm është me rëndësi për mbarëvajtjen e procesit dhe programit të studimit. Në rastin e këtij programi studimi, me vlerë për vlerësimin dhe marrjen e këshillave për përmirësim është marrëdhënia me bashkëpunëtorë nga bizneset në fushën e turizmit, informacion nga të cilët merret edhe përmes takimeve të realizuara. Takimet me student Alumni si edhe bashkëveprimi në seancat me lektorë të ftuar shërbejnë si marrje e ekspertizave të vyera nga aktorë të jashtëm. Vizita në institucion, takimi me Dekanin, departamentin dhe pedagogët e programit të studimit.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="630 1070 818 1144"></th> <th data-bbox="818 1070 1003 1144">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1003 1070 1217 1144">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1217 1070 1433 1144">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="630 1144 818 1193"></td> <td data-bbox="818 1144 1003 1193"></td> <td data-bbox="1003 1144 1217 1193"></td> <td data-bbox="1217 1144 1433 1193">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke</p>	<p>Transparenca lidhur me veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë garantohej përmes publikimit në web-site të institucionit të dokumentave të rëndësishme të cilat japin orientimet udhëheqëse për cilësinë. Ato përfshijnë planin strategjik të zhvillimit, vendimet e akreditimit institucional dhe të akreditimit të programeve të studimit, informacion mbi systemin e brendshëm të garantimit të cilësisë, kodi i cilësisë dhe veprimtaria e KPGSC. Gjithashtu kodi i cilësisë dhe Manuali i cilësisë janë publike dhe transparente në FAqen e Internetit të KU Logos. Publikimi i rezultateve të vlerësimit të porogramit të studimit respekton lirinë dhe etikën akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale. Raportet realizohen me synim jo identifikimin e rasteve individuale, por marrjen e praktikave më të mira dhe zgjidhjen e problemeve në rang institucional dhe të programit të studimit.</p>

respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	http://www.kulogos.edu.al/al/index.html# http://www.kulogos.edu.al/al/list-of-accreditations.html			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Bazuar në të gjitha raportimet e NJSBC si edhe KPGSC, institucioni ndërton një plan masash që synon përmirësimin e problematikave të evidentuara, kur ka të tilla. Gjatë procesit të vlerësimit si edhe akreditimit të mëparshëm institucional, evidencat janë përdorur për të përmirësuar aspektet e nevojshme për një rritje të cilësisë në mësimdhënie në programin e studimit. Institucioni përpiqet të zbatojë vazhdimisht masa për përmirësim të mundshme përgjatë procesit. Raportet e departamentit dhe të fakultetit dalin në përfundime lidhur me ecurinë e punës së njësisë kryesore/ njësisë bazë në vitin akademik pasardhës. Përmirësimet e lidhura me rritjen e angazhimit të pedagogëve në punën kërkimore shkencore, rritjen e angazhimit në projekte ndërkombëtare, rritjen e mobiliteteve, përfshirjen dhe angazhimin në metoda të reja dhe inovative në mësimdhënie, janë patjetër edhe efekt i analizave të punës në njësinë bazë dhe njësinë kryesore të pasqyruara në raportet vjetore të departamentit dhe njësisë kryesore. <i>Shtojca nr 37.5 Paketa e instrumentave të NJSBC Shtojcë nr. 37.4. 1-7 Raporte NJSBC në aspektet e ndryshme</i> <i>Shtojcat nr 37.7, Procedura e shqyrtimit të pyetësorëve të studentëve nga KPSSC; Shtojcë nr. 38.1 Raport I Departamentit të Menaxhimit Shtojcë nr. 38.2 Raport I Departamentit të Menaxhimit Shtojcë nr.65.1 Raporti vjetor I KU Logos për vitin 19-20 Shtojcë nr. 65.2 Raporti vjetor I KU Logos për vitin 20 - 21 Shtojca nr 89 Raport I Fakultetit të Ekonomisë</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Veprimtaritë periodike të institucionit për informimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me sigurimin e cilësisë, garantohen sipas rregulloreve të cilësisë. Me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë Institucioni organizon aktivitete dhe seminareve informuese me pedagogët dhe studentët, gjithashtu trajnime lidhur me procesin e vlerësimit të cilësisë dhe fushata informuese me qëllim ndërgjegjësimin e stafit dhe studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion <i>Shtojca nr. 8 Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë</i> <i>Shtojca nr 37.10 TRajnime për stafin akademik të realizuara nga KPSSC</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Veprimtaritë periodike të institucionit për informimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me sigurimin e cilësisë, garantohen sipas rregulloreve të cilësisë. Me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë Institucioni organizon aktivitete dhe seminareve informuese me pedagogët dhe studentët, gjithashtu trajnime lidhur me procesin e vlerësimit të cilësisë dhe fushata informuese me qëllim ndërgjegjësimin e stafit dhe studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion <i>Shtojca nr. 8 Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë</i> <i>Shtojca nr 37.10 TRajnime për stafin akademik të realizuara nga KPSSC</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Menaxhim Turizëm” të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “LOGOS”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Koherenca e gjatë e institucionit në treg si edhe emri i mire i institucionit janë bashkëshoqëruese të cilësisë së këtij program studimi.
2. Institucioni e ka shume në fokus këtë program studimi pavarësisht numrit të ulët të studentëve.
3. Institucioni ka priorizuar këtë program studimi edhe përmes kërkimit të lartë shkencor, konkretisht përmes projekteve të aplikuara dhe fituara në nivel ndërkombëtar ku studentët e këtij programi studimi janë përfituesit kryesorë.
4. Programi është në një departament dhe fakultet me staf drejtues me përvojë në arsimin e lartë dhe ka një kombinim të mirë të stafeve me përvojë me stafin e ri në kualifikim të vazhdueshëm.
5. Ka një strategji fokusimi në treg, duke mos kërkuar një rritje të pambështetur nga institucioni, por një rritje të qëndrueshme të ngadaltë, dhe pa marrë rreziqe të tepërta në një treg në ndryshim të vazhdueshëm lidhur me studentët dhe normat e rritjes në situatë problematike të demografisë së vendit.


Pika të dobta:

1. Planit mësimor i mungon të paktën një lëndë për bazat e turizmit që të japë konceptet bazë të turizmit që në fillimet e studimit të programit që në vitin e parë dhe i mungojnë lëndë me zgjedhje në vitin e tretë që mund të jenë lëndë që përkojnë me tendencat e turizmit sot në botë. (**Standardi I.3, kriteri 3 dhe Standardi II.1, kriteri 4,5**)
2. Numri i ulët i stafit të brendshëm me specializim në turizëm. (**Standardi II.5, kriteri 3**)

Rekomandime:

1. Të ristrukturohet plani mësimor me orientimet e mëposhtme në përmbajtje:
 - a. Të përfshihet lënda “Baza Turizmi” që në vitin e parë dhe lënda “Manaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm” në vitin e dytë semestri 1 ose viti parë semestri 2. Në këtë mënyrë studentët janë të kompletuar në njohuri të formimit bazë.
 - b. Të shtohen mundësitë e lëndëve me zgjedhje në vitin e tretë duke përfshirë lëndë bashkëkohore që përkojnë edhe me tendencat e fundit të turizmit dhe ndikimit të tij, të tilla si: Inovacioni dhe Sipërmarrja në Turizëm, Marketingu i turizmit, E-turizmi, etj. Lëndë të tilla janë tendenca prej një dekade në kurrikulat e programeve të rëndësishme në Europë, rajone dhe botë.

2. Stafi mësimdhënës në turizëm përbëhet në më së shumti nga pedagogë të jashtëm. Rekomandohet të shtohet stafi i brendshëm në mësimdhënie në lëndë të turizmit. Pavarësisht numrit të ulët të studenteve, investimi në staf të brendshëm të fokusuar dhe specializuar në turizëm përbën një qëndrueshmëri për vetë këtë program studimi, për më shumë duke gjykuar se ky institucion e ka mjaft në fokus turizmin aktualisht dhe në të ardhmen.
3. Rekomandojmë që institucioni të synoj më fortë në drejtimin e rritjes së numrit të studentëve për këtë program studimi.



Conclusions on the evaluation of the first cycle study program Bachelor of "Tourism Management" of the Higher Education Institution "LOGOS University"

Strengths and Affirmations:


1. The long-term coherence of the institution in the market along with its good reputation go hand in hand with the quality of this study program.
2. Regardless of the low number of students, the institution has a strong focus on this study program.
3. The institution has prioritized this study program through scientific research, specifically through international projects applied and won by the institution and where the students of this program are the main beneficiaries.
4. A department and faculty with an academic staff experienced in higher education, consisting of senior professors and young staff continuing education, offer the program.
5. It has a market-focused strategy, not seeking unsupported growth by the institution, but sustainable and steady growth, and without taking excessive risks in a constantly changing market regarding students and problematic growth rates of the country's demography.

Weaknesses:

1. The curriculum lacks at least one subject on the Fundamentals of Tourism to provide the basic concepts of tourism from the beginning of the study program in the first year and optional courses in the third year that may be subjects that coincide with today's tourism trends in the world. (Standard I.3, criterion 3 and Standard II.1, criterion 4,5)
2. Low number of internal staff specializing in tourism. (Standard II.5, criterion 3)


Recommendations:

1. We suggest restructuring the curriculum by including the following recommendations:
 - a. The inclusion of the subjects "Fundamentals of Tourism" in the first year and "Sustainable Tourism Management" in the second year, semester 1 or the first year, semester 2. This will allow students to acquire basic educational knowledge
 - b. Increased number of optional subjects in the third year including contemporary subjects that also coincide with the latest trends in tourism and its impact, such as Innovation and Entrepreneurship in Tourism, Tourism Marketing, E-tourism, etc. Such subjects have been the trend for a decade in the curricula of important programs in Europe, regions and the world.
2. The academic staff of tourism consists mostly of external lecturers. It is recommended to increase the number of internal staff in teaching tourism subjects. Despite the low



number of students, the investment in internal staff focused and specialized in tourism contributes to the sustainability of the study program itself, considering that the institution has actually a strong focus on tourism.

3. We recommend that the institution should aim at and work strongly towards increasing the number of students in this study program.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Shkolë e Gëzuar
Legj

*Ermedina
 Jozelka*
[Signature]